



USHTRIA



Viti i 82-të i botimit Nr. 34 (827990)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 28 gusht 2026



FA – PËR JETËN, PËR TOKËN, PËR NJERËZIT

» faqe 4



“GUNA TACTICAL”, INVESTIMI QË I JEP INDUSTRIJË SHQIPTARE TË MBROJTJES NJË DIMENSION TË RI

Industria shqiptare e mbrojtjes po hyn në një fazë të re zhvillimi, ku investimet, partneriteti publik-privat dhe krijimi i vendeve të reja të punës po shoqërojnë rritjen e kapaciteteve prodhuese. Ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi, ndau pamje nga kantieri i punës në kompaninë “Guna Tactical”, një prej investimeve më të rëndësishme të partneritetit publik-privat në industrinë shqiptare të mbrojtjes...

faqe 3



FORCA TOKËSORE, 26 VITE NË RRUGËN E TRANSFORMIMIT

Disa institucione maten me vite, mjaft të tjera maten me gjurmën që lënë në historinë e një vendi. Forca Tokësore është një prej tyre. Një çerek shekulli pas krijimit të saj, Forca Tokësore nuk është më ajo që ishte në ditët e para të gushtit të vitit 2000. Ajo ka kaluar përmes ndryshimeve të thella strukturore, reformave, misionëve, stërvitjeve, sfidave dhe një procesi të pandërprerë profesionalizimi. Nga një strukturë që duhej të ringrihej në një periudhë të vështirë për shtetin dhe Forcat e Armatosura, ajo është shndërruar...

faqe 8



NËN ZJARR, NGA QIELLI: PILOTI I FA QË U PËRBALL ME FLAKËT PËR TË SHPËTUAR PUKËN

Gojan-Gjegjan, Pukë, historia e njerëzve që nuk u tërhoqën kur flakët u afruan tek banesat. Një vend nuk matet me atë që thotë, por me njerëzit që ngrihen në këmbë kur gjithçka përreth duket se po shembet. Ka momente kur fjala “front” nuk lidhet me një hartë lufte, me tanke apo me armë, por me një mal të përfshirë nga flakët, me tym që mbulon...

faqe 4

FORCA TOKËSORE DREJT CERTIFIKIMIT TË GBKL SI “I GATSHËM PËR MISION”

Vlerësohen masat dhe përgatitjet për përmbushjen e standardeve të NATO-s

Në Komandën e Forcës Tokësore u zhvillua takimi për vlerësimin e masave të marra dhe ecurisë së përgatitjeve për certifikimin e Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (GBKL) si “i gatshëm për mision”, me pjesëmarrjen e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant **Arben Kingji**.

Takimi u drejtua nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor **Petrit Çuni**, dhe mbledhi drejtues të lartë të Forcave të Armatosura, drejtorët e Shtabit të Përgjithshëm, si dhe strukturat drejtuese dhe shtabin e Forcës Tokësore.

Në fokus, gatishmëria dhe standardet e kërkuara

Diskutimet u përqendruan te përmbushja e kërkesave, standardeve dhe objektivave të përcaktuara për certifikimin e GBKL-së, duke vlerësuar masat e ndërmarra deri në këtë fazë dhe detyrat që mbeten për t'u realizuar.

Procesi i certifikimit përbën një moment të rëndësishëm për vlerësimin e kapaciteteve operationale të njësisë dhe aftësisë së saj për të përmbushur detyrat e përcaktuara në kuadër të angazhimeve të Forcave të Armatosura dhe Aleancës.

Përgatitja për certifikim kërkon një nivel të lartë koordinimi ndërmjet strukturave, standardizim të procedurave, stërvitje të vazhdueshme dhe gatishmëri për të vepruar në një mjedis operacional të përbashkët.

Vlerësim për ecurinë e përgatitjeve

Në përfundim të takimit, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, vlerësoi ecurinë e përgatitjeve dhe angazhimin e strukturave të përfshira në këtë proces, duke nënvizuar rëndësinë e vijimit të punës me të njëjtin përkushtim deri në përfundimin e procesit të certifikimit.

Certifikimi i GBKL-së si “i gatshëm për mision” përfaqëson një tjetër hap në zhvillimin e kapaciteteve operationale të Forcës Tokësore dhe në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë ndaj Aleancës.



FORCA TOKËSORE NË STËRVITJEN “QUICK RESPONSE-26”, NË BOSNJE DHE HERCEGOVINË

Efektivët shqiptarë kontribuojnë në forcimin e gatishmërisë operationale të forcave shumëkombëshe të EUFOR-it

Efektivë nga **Batalioni i Këmbësorisë së Lehtë të Forcës Tokësore** do të marrin pjesë në stërvitjen shumëkombëshe “Quick Response-26”, në kuadër të përgatitjeve dhe forcimit të gatishmërisë operationale të forcave që mbështesin misionin e **Bashkimit Evropian, EUFOR, në Bosnjë dhe Hercegovinë**.

Pjesëmarrja e trupave shqiptare në këtë aktivitet stërvitor përbën një tjetër dëshmi të angazhimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operationet dhe nismat shumëkombëshe për sigurinë dhe stabilitetin në rajon.

Stërvitja synon të forcojë gatishmërinë, bashkëveprimin dhe aftësinë operationale të forcave pjesëmarrëse, duke krijuar mundësi për koordinim dhe veprim të përbashkët në një mjedis operacional shumëkombësh.

Për efektivët e Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë, pjesëmarrja në “Quick Response-26” përbën gjithashtu një mundësi për të vënë në praktikë përvojën e fituar në stërvitjet dhe angazhimet ndërkombëtare, si dhe për të rritur më tej ndërveprueshmërinë me forcat partnere dhe aleate.

Kontribut për sigurinë dhe stabilitetin rajonal

Angazhimi i Shqipërisë në misione dhe stërvitje të përbashkëta në rajon tregon rëndësinë që Forcat e Armatosura i kushtojnë sigurisë kolektive dhe



stabilitetin në Ballkanin Perëndimor.

Nëpërmjet pjesëmarrjes në “Quick Response-26”, efektivët shqiptarë do të kontribuojnë në përgatitjen e forcave shumëkombëshe për reagim të shpejtë dhe efektiv, në mbështetje të objektivave të misionit **EUFOR “Althea”**.

Për Shqipërinë, çdo angazhim i tillë përfaqëson jo vetëm përmbushje të detyrimeve dhe përgjegjësi ndërkombëtare,



por edhe një mundësi për të rritur kapacitetet profesionale të personelit, për të shkëmbyer eksperiencën dhe për të forcuar besimin me partnerët.

Pjesëmarrja në “Quick Response-26” konfirmon kështu gatishmërinë e Forcës Tokësore dhe të Forcave të Armatosura shqiptare për të kontribuar në përpjekjet e përbashkëta për një mjedis më të sigurt, të qëndrueshëm dhe paqësor në rajon.

“GUNA TACTICAL”, INVESTIMI QË I JEP INDUSTRIISË SHQIPTARE TË MBROJTJES NJË DIMENSION TË RI

Nga prodhimi i uniformave për Forcat e Armatosura, drejt tregut rajonal dhe eksporteve

Industria shqiptare e mbrojtjes po hyn në një fazë të re zhvillimi, ku investimet, partneriteti publik-privat dhe krijimi i vendeve të reja të punës po shoqërojnë rritjen e kapaciteteve prodhuese.

Ministri i Mbrojtjes, z. **Ermal Nufi**, ndau pamje nga kantieri i punës në kompaninë “**Guna Tactical**”, një prej investimeve më të rëndësishme të partneritetit publik-privat në industrinë shqiptare të mbrojtjes.

Ministri Nufi bëri të ditur se “**Guna Tactical**” synon të prodhojë veshje ushtarake jo vetëm për nevojat e Shqipërisë, por edhe për tregun rajonal dhe vendet e tjera.

“**Guna Tactical**’ do të prodhojë veshje ushtarake jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për rajonin dhe për vendet e tjera”, - u shpreh ministri Nufi.

Mbi 290 të punësuar, objektivi mbi 1,000

Një prej dimensioneve më të rëndësishme të këtij investimi lidhet me **punësimin dhe ndikimin ekonomik e social në komunitet**.

Sipas ministrit të Mbrojtjes, aktualisht në këtë industri janë të punësuar **mbi 290 persona**, ndërsa parashikohet që numri i të punësuarve të rritet në **mbi 1,000**, në momentin kur kantieri të jetë plotësisht funksional.

Ky zhvillim e vendos industrinë e mbrojtjes jo vetëm në funksion të prodhimit dhe furnizimit të strukturave të sigurisë, por edhe si një sektor që krijon vende pune dhe gjeneron aktivitet ekonomik.

“**Jemi krenarë për faktin që kjo industri, jo vetëm gjeneron të ardhura, por punëson njerëz dhe ndikon në komunitet çdo ditë**”, - theksoi ministri Nufi.

Partneritet publik-privat për prodhimin “Made in Albania”

“Guna Tactical” është krijuar si një **ndërmarrje e përbashkët (joint venture) mes ndërmarrjes shtetërore KAYO dhe kompanisë private MSSC**.

Në fokus të aktivitetit të saj janë **projektimi, prod-**



himi, tregtimi dhe eksporti i uniformave ushtarake dhe aksesoreve, me destinacion kryesor Forcat e Armatosura, strukturat e tjera të sigurisë, vendet e rajonit dhe aleatët e NATO-s.

Investimi përfaqëson kështu një tjetër hap drejt krijimit të një industrie shqiptare të mbrojtjes me kapacitete më të mëdha prodhuese dhe me perspektivë për t’u shtrirë përtej tregut vendas.

Nga uniforma ushtarake te pajisjet dhe aksesorët që shoqërojnë shërbimin në terren, synimi është krijimi i një zinxhiri prodhues që mund të mbështesë nevojat kombëtare, ndërsa njëkohësisht të krijojë mundësi për **eksport dhe bashkëpunim me tregjet e huaja**.

Industria e mbrojtjes, një sektor me ndikim për ekonominë



Zhvillimi i kapaciteteve të tilla shkon përtej dimensionit ushtarak. Ai lidhet drejtpërdrejt me ekonominë, punësimin, teknologjinë dhe zhvillimin e industrisë vendase.

Kantieri i “Guna Tactical” është një prej shembujve të këtij orientimi: **investim në prodhim, investim në njerëz dhe investim në një sektor strategjik për të ardhmen e vendit**.

Nëse objektivi i zgjerimit realizohet, rritja e numrit të të punësuarve në mbi 1,000 persona do të përbënte një ndikim të rëndësishëm jo vetëm për kompaninë, por edhe për komunitetin dhe ekonominë lokale.

Industria shqiptare e mbrojtjes po synon kështu të mos jetë vetëm një sektor që furnizon nevojat e brendshme, por një industri që prodhon, punëson dhe synon të konkurojë në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare.

FORCAT DETARE SHQIPTARE DHE GJERMANE, STËRVITJE E PËRBASHKËT NË UJËRAT SHQIPTARE

Anija gjermane A-512 “**MOSEL**” zhvilloi vizitë portuale në Durrës, ndërsa “**LISSUS**” P-133 dhe “**MOSEL**” realizuan skenarë të përbashkët stërvitorë. Forcimi i bashkëpunimit dhe ndërveprueshmërisë mes Forcës Detare Shqiptare dhe Forcave Detare Gjermane ishte në fokus të vizitës portuale të anijes **A-512 “MOSEL”** në Portin e Durrësit.

Gjatë ditëve të qëndrimit në Shqipëri, pjesëtarë të ekuipazhit të anijes gjermane zhvilluan një **vizitë kortezeje në ambientet e Komandës së Forcës Detare Shqiptare**, ku u pritën nga shefi i Shtabit të Forcës Detare, **Kapiten i Rangut I-rë Arjan Çollaku**. Vizita shërbeu si një mundësi për forcimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe shkëmbimin e eksperiencave ndërmjet dy forcave detare.

“**LISSUS**” dhe “**MOSEL**”, në stërvitje të përbashkët

Në kuadër të vizitës u zhvillua gjithashtu një **stërvitje e përbashkët detare** ndërmjet anijes **P-133 “LISSUS”** të Forcës Detare Shqiptare dhe anijes **A-512 “MOSEL”** të Forcave Detare Gjermane.

Gjatë stërvitjes u realizuan **skenarë të ndryshëm stërvitorë**, duke krijuar mundësi për koordinimin e veprimeve dhe rritjen e ndërveprueshmërisë ndërmjet ekuipazheve.

Aktivitete të tilla kanë rëndësi për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe për konsolidimin e bashkëpunimit ndërmjet forcave detare aleate e partnere.

Për Forcën Detare Shqiptare, zhvillimi i stërvitjeve të përbashkëta me forcat e vendeve partnere është pjesë e përpjekjeve për të ruajtur dhe zhvilluar më tej **gatishmërinë operationale, profesionalizmin dhe aftësinë për të vepruar në mënyrë të koordinuar në mjedisin detar shumëkombësh**.

Vizita e anijes A-512 “**MOSEL**” dhe stërvitja me P-133 “**LISSUS**” dëshmojnë rëndësinë e bashkëpunimit detar dhe të shkëmbimit të eksperiencave në funksion të **sigurisë, stabilitetit dhe forcimit të partneritetit ndërmjet Shqipërisë dhe Gjermanisë**.



FORCA DETARE DHE POLICIA KUFITARE, NË GATISHMËRI PËR SIGURINË NË DET

Operacionet e përbashkëta do të vijojnë gjatë gjithë sezonit turistik

Siguria në det, zbatimi i ligjshmërisë dhe garantimi i mbarëvajtjes së turizmit detar janë në fokus të planit të bashkëpunimit ndërmjet **Forcës Detare/Rojës Bregdetare dhe Policisë Kufitare dhe Migracionit** gjatë këtij sezoni turistik.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, anija “**Oriku**” P-132, në koordinim me strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit, zhvilloi një operacion të përbashkët në hapësirën detare, përgjatë itinerarit nga **Pashalimani, Gjiri i Vlorës, Gadishulli i Karaburunit deri në Gjirin e Gramës**.

Operacioni kishte në fokus monitorimin e hapësirës detare, rritjen e sigurisë dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave përgjegjëse për kontrollin dhe sigurinë në det.

Siguria e jetës, prioritet

Gjatë sezonit turistik, hapësirat detare shqiptare përballen me një intensifikim të ndjeshëm të lëvizjes së mjeteve lundruese dhe aktivitetit turistik. Në këtë kuadër, bashkëpunimi ndërinstitucional merr një rëndësi të veçantë për parandalimin e shkeljeve dhe garantimin e respektimit të rregullave të lundrimit. Operacionet e përbashkëta të **Forcës Detare/Rojës Bregdetare dhe Policisë Kufitare dhe Migracionit** do të vijojnë përgjatë gjithë sezonit turistik, me synim garantimin e sigurisë së jetës në det, parandalimin e shkeljeve dhe zbatimin e ligjit. Prania e strukturave të sigurisë në hapësirën detare synon të krijojë një mjedis më të sigurt për pushuesit, turistët, operatorët turistikë dhe të gjithë përdoruesit e hapësirës detare.

Një det i sigurt është pjesë e një turizmi të sigurt.

Përmes koordinimit dhe operacioneve të përbashkëta, strukturat përgjegjëse vijojnë të kontribuojnë për një sezon turistik të qetë, të sigurt dhe në përputhje me ligjshmërinë.





NËN ZJARR, NGA QIELLI: PILOTI I FA QË U PËRBALL ME FLAKËT PËR TË SHPËTUAR PUKËN

Gojan-Gjegjan, Pukë, historia e njerëzve që nuk u tërhoqën kur flakët u afruan tek banesat

Një vend nuk matet me atë që thotë, por me njerëzit që ngrihen në këmbë kur gjithçka përreth duket se po shembet.

Ka momente kur fjala “front” nuk lidhet me një hartë lufte, me tanke apo me armë, por me një mal të përfshirë nga flakët, me tym që mbulon qiellin dhe me njerëz që përpigën të mbrojnë shtëpitë e tyre.

Në Gojan-Gjegjan të Pukës, për ditë me radhë, zjarri krijoi një skenë që banorët e përshkruan si një front lufte. Flakët përparonin në një terren të vështirë. Temperaturat e larta e bënë ndërhyrjen edhe më të rrezikshme. Era ndryshonte drejtimin e zjarrit dhe çdo vatër e re mund të shndërrohej në një kërcënim për banesat. Në tokë, zjarrfikësit përballeshin me flakët. Në terren, Forcat e Armatosura përpigeshin të mbronin zonat e rrezikuara.

Nga qielli, Forcat Ajrore ndërhyenin aty ku terreni e bënte të pamundur ose jashtëzakonisht të vështirë ndërhyrjen tokësore.

Dhe mes tyre ishin banorët. Njerëz të zakonshëm që, në një situatë të jashtëzakonshme, u kthyen në pjesë të një mburoje njerëzore për shtëpitë, pronat dhe komunitetin e tyre. Në fund të ditëve të gjata të ankthit, një fjalë e thjeshtë e një banori përmbledh gjithçka: “Besoj se shpëtuam”. Por pas kësaj fjalie qëndrojnë ditë të tëra pune, lodhjeje, frike dhe sakrifice, qëndrojnë njerëzit që nuk u larguan.

KUR SHTËPITË RRETHOHEN NGA ZJARRI

Për një njeri që e sheh zjarrin nga larg, flaka mund të duket si një spektakël natyror. Për atë që e ka shtëpinë pranë saj, zjarri është diçka krejt tjetër. Është frika se mos humbet gjithçka. Është pyetja se çfarë do të marrësh me vete nëse duhet të largohesh. Është kujtimi i një jete të tërë të mbledhur mes katër mureve. Është toka. Është shtëpia. Është puna e prindërve. Është kujtesa. Është vendi ku ke lindur.

Dhe kur flakët afrohen, njeriu nuk mendon më për statistika. Mendon për familjen. Mendon për fëmijët. Mendon për prindërit. Mendon për atë që ka ndërtuar gjatë gjithë jetës. Në Gojan-Gjegjan, banorët e përjetuan këtë ankth për ditë me radhë. Zjarri nuk ishte më një lajm që shihej në ekran.

Ishte aty,

Në shpatet,

Nënkolonel Klajdi Tushe, kur qielli u bë fronti i betejës dhe helikopteri arma e mbrojtjes së banorëve

Në Gojan-Gjegjan të Pukës, për ditë me radhë, zjarri krijoi një skenë që banorët e përshkruan si një front lufte. Flakët përparonin në një terren të vështirë.

Temperaturat e larta e bënë ndërhyrjen edhe më të rrezikshme. Era ndryshonte drejtimin e zjarrit dhe çdo vatër e re mund të shndërrohej në një kërcënim për banesat. Në tokë, zjarrfikësit përballeshin me flakët. Në terren, Forcat e Armatosura përpigeshin të mbronin zonat e rrezikuara.

Në pyll,
Në ajër,
Pranë shtëpive.

Dhe ndërsa banorët tërhiqeshin nga zonat më të rrezikshme, drejt tyre shkonin ata që kishin ardhur për t'i mbrojtur.

PILOTI QË E SHOI ZJARRIN NGA QIELLI

Në historinë e kësaj beteje me flakët, një prej figurave që banorët veçuan është **nënkolonel Klajdi Tushe**, pilot i

Forcave Ajrore. Puna e pilotit në një operacion të tillë nuk është thjesht të ngrihet në ajër dhe të hedhë ujë.

Pas çdo ndërhyrjeje ka një zinxhir vendimmarrjeje. Ka koordinim. Ka njohje të terrenit. Ka vlerësim të rrezikut. Ka përcaktim të objektivit. Ka sekonda në të cilat çdo vendim duhet të jetë i saktë. Nga lart, zjarri nuk duket vetëm si një mur flakësh. Ai është një hartë që ndryshon çdo çast. Një vatër mund të zgjerohet. Një erë mund ta kthejë drejtimin e flakëve. Një zonë që pak minuta më parë dukej e sigurt mund të bëhet e rrezikshme. Dhe pikërisht aty kërkohet



profesionalizmi. Piloti duhet të punojë në kufijtë e sigurisë, duke mbajtur në mendje njëkohësisht objektivin e misionit dhe mbrojtjen e ekuipazhit. Për banorët në tokë, avioni që shfaqet mbi zonën e zjarrit është një pamje shprese. Një pikë nga qielli që vjen në momentin kur toka duket e pafuqishme përballë flakëve. Në dëshminë e tij, banori Daniel Pereda ka shprehur mirënjohje të veçantë për Forcat Ajrore dhe për nënkolonel Tushen, duke e konsideruar ndërhyrjen nga ajri vendimtare në momentet më kritike.

Dhe ndoshta ky është një nga përkufizimet më të bukura të shërbimit: **Të jesh aty pikërisht kur dikush tjetër ka nevojë për ty.**

ATA QË QËNDRUAN NË TOKË

Nëse qielli kishte pilotët, toka kishte zjarrfikësit. Ata ishin aty që nga ditët e para. Përballë temperaturave të larta. Përballë terrenit të thyer. Përballë lodhjes

Përballë një zjarri që nuk sillej sipas parashikimeve. Zjarrfikësi nuk e lufton zjarrin nga një distancë e sigurt. Ai afrohet. Ai futet aty ku nxehtësia bëhet e padurueshme. Ai punon me pajisje të rënda. Ai duhet të marrë vendime në kushte ku sekondat mund të kenë rëndësi. Dhe shpesh, ndërsa të tjerët largohen nga rreziku, ai shkon drejt tij.

Në Pukë, zjarrfikësve të zonës iu bashkuan edhe kolegë nga Fushë-Arrëzi, Kukësi, Shkodra, Hasi dhe Kamza. Kjo nuk ishte më vetëm një betejë lokale. Ishte një përpjekje e përbashkët. Një zjarr në një zonë mund të bëhet kërcënim për një komunitet të tërë. Dhe përgjigjja ndaj tij kërkon bashkëpunim. Nuk ka rëndësi nga cili qytet vjen zjarrfikësi. Kur thirret për ndihmë, ai shkon. Ky është një nga kuptimet më të forta të uniformës. Ajo i bashkon njerëzit përtej kufijve administrativë.

FORCAT E ARMATOSURA, ATY KU BANORI TËRHIQET

Në një operacion emergjence, shpesh ndodh diçka që publiku nuk e sheh. Kur rreziku rritet, banorët duhet të tërhiqen. Por dikush duhet të qëndrojë. Dikush duhet të monitorojë. Dikush duhet të sigurojë zonën. Dikush duhet të kontrollojë vatrat. Dikush duhet të ndihmojë në mbrojtjen e banesave. Dhe aty shfaqet roli i Forcave të Armatosura. Në dëshminë e tij, Daniel Pereda i ka falënderuar veçanërisht Forcat e Armatosura për profesionalizmin dhe praninë e tyre në terren. Ai përshkruan një realitet ku ushtarakët vepronin pikërisht në ato zona ku banorët nuk mund të qëndronin më. Kjo është një prej pamjeve më domethënëse të misionit të tyre: Kur qytetari tërhiqet për t’u mbrojtur, ushtaraku afrohet për të mbrojtur. Kjo është arsyeja pse uniforma nuk është thjesht një veshje. Ajo është një përgjegjësi. Një premtim. Një detyrim ndaj jetës.

NUK ISHTE VETËM ZJARRI QË U SHUA

Kur flitet për një zjarr të madh, zakonisht pyetja e parë është:

Sa hektarë u dogjën? Por pas një zjarri të madh ka shumë më tepër se një numër. Ka pyll të dëmtuar. Ka bimësi të humbur. Ka toka të nxira. Ka kafshë të egra që humbin habitatin. Ka fermerë që shohin pronat e tyre të dëmtuara. Ka

banorë që për ditë të tëra jetojnë me ankthin se mos humbin shtëpitë. Ka familje që duhet të pastrojnë pasojat e një nate të gjatë. Ka një peizazh që nuk është më ai i mëparshmi. Zjarri lë pas një heshtje të çuditshme. Atje ku më parë kishte gjelbërim, mbetet hiri. Atje ku kishte zhurmë natyre, mund të mbetet një terren i heshtur. Dhe megjithatë, mes kësaj pamjeje të rëndë, mbetet edhe një tjetër gjurmë: gjurma e njerëzve që u përpoqën ta ndalnin.

ÇFARË KA LËNË PAS ZJARRI?

HIRI, POR EDHE NJË MËSIM. Zjarri ka lënë pas dëme. Por ka nxjerrë në pah edhe diçka tjetër: sa e rëndësishme është që strukturat e ndryshme të veprojnë së bashku. Në një emergjencë të madhe nuk mjafton një institucion. Duhet koordinim. Duhet komunikim. Duhet disiplinë. Duhet informacion në kohë reale. Duhet mbështetje nga ajri. Duhet ndërhyrje tokësore. Duhet angazhimi i komunitetit. Dhe mbi të gjitha, duhet një drejtim i qartë. Përtej emocioneve të një banori që sapo ka parë shtëpinë e tij të shpëtojë, kjo dëshmi ka një rëndësi tjetër. Sepse në situata të tilla, koordinimi është po aq i rëndësishëm sa guximi. Një zjarr mund të mposhtet vetëm kur informacioni, njerëzit, mjetet dhe vendimmarrja funksionojnë si një trup i vetëm.

BANORËT, HERONJ PA UNIFORMË

Por në këtë histori nuk duhet harruar askush. Sepse në Gojan-Gjegjan, përballë zjarrit nuk ishin vetëm strukturat shtetërore. Ishin edhe banorët.

Ata që njihnin çdo shteg. Çdo përrua. Çdo rrugë. Çdo shtëpi. Çdo copë toke. Ata që e dinin se ku mund të kalonte zjarri. Ata që ndihmonin njëri-tjetrin. Ata që qëndruan pranë familjeve të tjera. Në raste fatkeqësish, komuniteti bëhet një lloj mburoje. Njeriu nuk mendon vetëm për shtëpinë e tij. Mendon edhe për shtëpinë e fqinjit. Dhe pikërisht këtu lind solidariteti. Një kovë ujë. Një informacion. Një ndihmë. Një derë e hapur. Një telefonatë. Një dorë e shtrirë. Në një situatë normale, këto mund të duken gjëra të vogla. Në mes të një zjarri, ato mund të kenë vlerën e një jete.

GAZETARËT QË NUK E LANË ZJARRIN TË MBETET PA ZË

Në dëshmitë e tyre, banorët kanë falënderuar edhe gazetarët që raportuan në kohë reale. Është një detaj që meriton të ndalet. Sepse në një emergjencë, informacioni është pjesë e shpëtimit. Kur publiku informohet, strukturat vihen në lëvizje. Kur një situatë dokumentohet, ajo nuk mbetet e padukshme. Kur një gazetar raporton nga terreni, ai nuk po transmeton vetëm një lajm.

Ai po tregon se ku është rreziku. Kush ka nevojë për ndihmë. Çfarë po ndodh. Dhe sa urgjente është situata. Në këtë kuptim, edhe gazetaria bëhet pjesë e zinxhirit të reagimit. Jo duke luftuar flakët me ujë, por duke luftuar një tjetër rrezik: heshtjen.

“BESOJ SE SHPËTUAM”

Është një togfjalësh. Por ndoshta asnjë raport zyrtar nuk

mund ta përshkruajë më mirë atë që ka përjetuar një familje e rrethuar nga zjarri.

“Besoj se shpëtuam”. Në këtë togfjalësh ka frikë. Ka lehtësim. Ka lodhje. Ka mirënjohje. Por edhe një kujtim të hidhur: sa pranë ishte rreziku.

Një shtëpi e shpëtuar nuk është thjesht një ndërtesë që nuk u dogj. Është një familje që nuk humbi strehën. Është një album fotografish që nuk u kthye në hi. Është një dhomë fëmijësh që mbeti në këmbë. Është një oborr ku dikush do të kthehet përsëri. Është një jetë që vazhdon. Dhe pas saj janë njerëz që ndoshta nuk do të shfaqen kurrë në faqet e para të gazetave.

Prandaj quhen: **Heronjtë e Heshtur.**

HERONJTË NUK KËRKOJNË DUARTROKITJE

Një nga gjërat më të bukura të profesioneve të shërbimit është se njerëzit që i ushtrojnë nuk hyjnë në rrezik për t’u bërë të famshëm. Zjarrfikësi nuk hyn në flakë për fotografinë. Ushtaraku nuk qëndron në terren për duartrokitjen. Piloti nuk ngrihet në qiell për një titull gazete. Banori nuk mbron fqinjin për një medalje.

Ata veprojnë sepse ky është detyrimi i tyre njerëzor dhe profesional. Kjo është arsyeja pse **“Heronjtë e Heshtur”** janë kaq të rëndësishëm. Sepse historia e tyre nuk është gjithmonë spektakolare. Shpesh është e padukshme. Është një turn i gjatë. Një uniformë e mbuluar me pluhur. Një fytyrë e lodhur. Një palë çizme të nxira nga terreni. Një helikopter që ngrihet përsëri. Një zjarrfikës që kthehet përsëri në vijën e zjarrit.

Një ushtar që pyet: “A ka ende ndonjë vatër?”

Dhe përgjigjja është: “Po.”

Dhe ai kthehet përsëri.

NJË OPERACION, SHUMË DUAR, NJË QËLLIM

Në Gojan-Gjegjan u bashkuan shumë njerëz. Zjarrfikës. Ushtarakë. Pilotë. Banorë. Struktura vendore. Gazetarë. Dhe shumë të tjerë që ndihmuan në mënyrën e tyre.

Secili kishte një rol. Por qëllimi ishte i njëjtë: Të mos lejohej zjarri të merrte atë që mund të mbrohej. Ky është mësimi më i madh i kësaj ngjarjeje. Në përballjen me fatkeqësitë natyrore, nuk ka një hero të vetëm. Ka një zinxhir heronjsh. Dhe nëse një hallkë mungon, gjithçka bëhet më e vështirë. Prandaj një operacion i suksesshëm nuk duhet parë vetëm përmes numrit të mjeteve të përdorura apo orëve të punës. Duhet parë përmes jetëve, shtëpive dhe komuniteteve që u mbrojtën.

KUR ZJARRI SHUHET, HEROI MBETET

Në fund, zjarri nuk lë vetëm hi. Lë pyetje. Çfarë humbëm? Çfarë shpëtuam? Çfarë mësuam? Dhe mbi të gjitha: Kush ishte aty kur kishim më shumë nevojë?

Në Pukë, përgjigjja është e qartë. Ishin zjarrfikësit që nuk u tërhoqën. Ishin Forcat e Armatosura që qëndruan në terren. Ishin pilotët që luftuan nga qielli. Ishin banorët që nuk e lanë njëri-tjetrin vetëm.

Ishin të gjithë ata që, në një mënyrë apo në një tjetër, u bënë pjesë e luftës kundër flakëve. Prandaj, kur një banor thotë: “Besoj se shpëtuam”, pas këtij togfjalëshi duhet të lexojmë shumë më tepër se një fund të lumtur.

Duhet të lexojmë punën e atyre që qëndruan. Duhet të lexojmë lodhjen e atyre që nuk fjetën. Duhet të lexojmë guximin e atyre që hynë në rrezik. Duhet të lexojmë profesionalizmin e atyre që drejtuan operacionin. Dhe duhet të lexojmë mirënjohjen e një komuniteti që e di se shtëpitë e tij nuk u mbrojtën vetë.

U mbrojtën nga njerëzit.

Nga njerëz me uniformë dhe pa uniformë.

Nga njerëz që nuk kërkuan asgjë në këmbim.

Nga njerëz që bënë detyrën e tyre.

Dhe pikërisht për këtë, ata meritojnë të quhen:

HERONJTË E HESHTUR

Sepse heroi i vërtetë nuk është gjithmonë ai që shfaqet në fotografi. Ndonjëherë është ai që qëndron në sfond. Ai që kthehet në terren edhe kur është i lodhur. Ai që ngrihet në qiell kur toka është përfshirë nga flakët. Ai që vendos uniformën dhe niset pa e ditur se kur do të kthehet. Ai që mbron shtëpinë e një tjetri sikur të ishte e tija. Dhe kur gjithçka përfundon, ai largohet në heshtje. Pa kërkuar asgjë. Vetëm me bindjen se bëri atë që duhej bërë. Zjarri mund të lërë pas hi.

Por njerëzit që e luftojnë lënë pas një shembull.

Dhe shembujt, ndryshe nga zjarri, nuk shuhen.



360°

Forcat e Armatosura



HERONJ NË UNIFORMË



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Datat nuk janë thjesht shifra në kalendar. Ka ditë që, sa herë rikthehen, na detyrojnë të ndalemi dhe të mendojmë se çfarë mund të bëjë një njeri i vetëm për të ndryshuar mënyrën se si një shoqëri e sheh veten dhe si bota e sheh atë shoqëri.

26 gushti është një prej këtyre datave.

Në këtë ditë, në dy vite të ndryshme, historia shqiptare mori dy prej figurave të saj më të veçanta: më 26 gusht 1910 lindi në Shkup **Agnes Gonxhe Bojaxhiu**, vajza shqiptare që bota do ta njihë si **Nënë Tereza**; ndërsa më 26 gusht 1938, larg atdheut, në një sanatorium pranë Torinos, mbylli sytë **Migjeni – Millosh Gjergj Nikolla**, poeti që i dha letërsisë shqipe një zë të ri, të trazuar, rebel dhe thellësisht njerëzor.

Në pamje të parë, ata duken si dy botë krejt të ndryshme. Nënë Tereza zgjodhi rrugën e besimit, shërbimit dhe mëshirës. Migjeni zgjodhi rrugën e revoltës, kritikës dhe së vërtetës sociale. Njëra iu përkul njeriut të rrëzuar për ta ngritur, tjetri e vështroi shoqërinë në sy për t'i treguar plagët e saj.

Por, në thelb, ata takohen në një pikë të përbashkët: **në qendër të veprës së tyre qëndron njeriu.** Dhe ndoshta pikërisht këtu qëndron madhështia e tyre.

NËNË TEREZA, SHQIPTARJA QË E BËRI DASHURINË NJË MISION

Agnes Gonxhe Bojaxhiu lindi më 26 gusht 1910, në Shkup, në një familje katolike shqiptare. Ishte një vajzë e vogël nga një familje shqiptare e Ballkanit, në një kohë kur bota ishte ende larg, nga ta imagjinonte se emri i saj do të bëhej një ditë sinonim i mëshirës dhe bamirësisë.

Rrugëtimi i saj shpirtëror nisi në Letnicë, në vitin 1928. Më pas ajo shkoi në Irlandë, ku mori formimin fetar, dhe prej andej u nis drejt Indisë. Në Kalkutë do të gjente jo vetëm vendin ku do të shërbente, por edhe misionin e gjithë jetës së saj. Ajo nuk zgjodhi të jetonte larg varfërisë. Zgjodhi të hynte në të.

Nuk e shikoi të varfrin nga larg. U ul pranë tij. Nuk e konsideroi të braktisurin si një problem të shoqërisë. E pa si një genie njerëzore që kishte nevojë për dorën e një tjetri.

Në vitin 1950 themeloi **“Misionaret e Bamirësisë”**, duke krijuar një prej organizatave më të njohura humanitare në botë. Prej atij momenti, emri i saj u bë i pandashëm nga një ide e thjeshtë, por jashtëzakonisht e fuqishme, njeriu nuk humbet dinjitetin e tij vetëm sepse është i varfër, i sëmurë, i braktisur apo i harruar.

Nënë Tereza e kuptoi se humanizmi nuk matet me fjalët që themi, por me atë që bëjmë për tjetrin.

Dhe ky ishte revolucion i saj.

Një revolucion pa armë.

Pa pushtet politik.

Pa ushtri.

Pa kufij.

Ajo ndërtoi ura aty ku të tjerët shihnin mure. Në vitet 1980–1990, misionet e saj u shtrinë edhe në disa vende komuniste të kohës, përfshirë ish-Bashkimin Sovjetik, Shqipërinë dhe Kubën.

Në një botë të ndarë nga ideologjitë, ajo zgjodhi të mos pyeste se në cilën anë të kufirit ishte njeriu.

Pyeste vetëm: A ka nevojë për ndihmë?

Kjo e bëri atë një figurë që kapërceu politikën.

Në vitin 1979, **Çmimi Nobel për Paqen** e vendosi emrin e saj në historinë botërore. Por për shqiptarët, ajo mbeti gjithmonë diçka më shumë se një fituese e Nobelit.

Mbeti shqiptarja që nuk e harroi prejardhjen. **“Sa i përket gjakut dhe prejardhjes, unë jam shqiptare”**. Në një fjalë të tillë nuk kishte as mburrje, as retorikë. Kishte identitet.

Një identitet që ajo e mbajti me qetësi dhe dinjitet, ndërsa jetonte larg vendit të origjinës.

Vizita e saj në Shqipëri në vitin 1993, në kuadër të vizitës së Papa Gjon Palit II, ishte një moment i jashtëzakonshëm për shqiptarët. Pas dekadash izolimi, emri i një shqiptareje që ishte bërë simbol botëror i humanizmit u kthye në vendin e saj të origjinës.

Ishte një kthim simbolik.

Një vajzë e lindur në Shkup, që kishte ikur e re drejt një bote tjetër, kthehej tashmë si një nga figurat më të njohura të planetit.

Ajo nuk solli me vete pushtet.

Solli kujtesën.

Solli mëshirën.

Solli emrin shqiptar.

MIGJENI, ZËRI QË NUK PRANOI TË HESHTË

Nëse Nënë Tereza e përqafoi njeriun e vuajtur, Migjeni e ngriti zërin për të.

Nëse ajo kërkoi ta lehtësonte dhimbjen, ai kërkoi të zbulonte arsyen pse ajo dhimbje ekzistonte.

Këtu nis madhështia e Migjenit.

Millosh Gjergj Nikolla ishte një prej zërave më tronditës të

DY SHQIPTARË, DY RRUGË TË NDRYSHME, NJË GJURMË E PASHLYESHME NË HISTORINË E NJERËZIMIT

Nënë Tereza dhe Migjeni, njëra i dha botës dashurinë si shërbim, tjetri i dha Shqipërisë të vërtetën si ndërgjegje



letërsisë shqipe të shekullit XX. Krijimtaria e tij u përqendrua te varfëria, mjerimi, padrejtësia, hipokrizia dhe vuajtja njerëzore.

Migjeni nuk shkroi për një Shqipëri të zbukuruar. Shkroi për Shqipërinë që dhembte.

Ai pa fëmijët e uritur, njerëzit e raskapitur, gratë e vuajtura, shoqërinë e mbyllur në varfëri dhe një realitet ku njeriu shpesh dukej sikur ishte i dënuar të lindte dhe të vdiste pa e provuar kurrë dinjitetin.

Prandaj letërsia e tij ishte tronditëse.

Sepse nuk i vinte lule plagës. Ia hiqte fashën. Dhe e tregonte.

Ndikimi i Migjenit ishte i dukshëm sidomos te brezat e rinj. Ai solli një frymë të re në letërsinë shqipe, duke e larguar atë nga disa prej skemave tradicionale dhe duke e kthyer poezinë në një instrument të fuqishëm të ndërgjegjes sociale.

Pas Luftës së Dytë Botërore, vepra e tij u botua dhe u përhap më gjerësisht, duke u bërë pjesë e rëndësishme e trashëgimisë letrare shqiptare. Por madhështia e Migjenit nuk qëndron vetëm te ndikimi i tij letrar. Ajo që mbetet është guximi për të thënë atë që dhemb. Sepse shoqëritë nuk përparojnë vetëm nga ata që i lavdërojnë. Përparojnë edhe nga ata që kanë guximin t'u tregojnë plagët.

Migjeni ishte një prej tyre. Ai nuk kishte nevojë të jetonte gjatë për të lënë një gjurmë të gjatë.

Në fund të vitit 1937 shkoi në Itali për t'u kuruar. U shtrua në një sanatorium pranë Torinos. Më 26 gusht 1938, vetëm 27 vjeç, ai ndërroi jetë.

Një jetë e shkurtër.

Një vepër e madhe.

Një zë që vazhdon të dëgjohej.

DY RRUGË, NJË NJERI

Çfarë i bashkon, pra, Nënë Terezën dhe Migjenin?

Nuk është feja.

Nuk është letërsia.

Nuk është profesioni.

Nuk është as koha, sepse ata i përkasin dy përvojave të ndryshme.

Ajo që i bashkon është ndjeshmëria ndaj vuajtjes njerëzore. Nënë Tereza e pa vuajtjen dhe tha: **“Duhet të bëj diçka”**.

Migjeni e pa vuajtjen dhe tha: **“Duhet të flas për të”**.

Njëra veproi.

Tjetri shkroi.

Njëra ndërtoi shtëpi për të braktisurit.

Tjetri ndërtoi një gjuhë për ata që nuk kishin zë.

Në këtë kuptim, ata janë dy forma të së njëjtës përgjegjësi njerëzore.

Të mos jesh indiferent.

Dhe ndoshta kjo është pikërisht ajo që shoqëria jonë moderne ka më shumë nevojë të kujtojë.

Sepse sot kemi më shumë mjete komunikimi se kurrë më parë, por jo domosdoshmërisht më shumë komunikim njerëzor. Kemi më shumë pasuri, por jo gjithmonë më shumë solidaritet. Kemi më shumë fjalë për humanizmin, por jo gjithmonë më shumë humanizëm.

Nënë Tereza na kujton se mirësia nuk është dobësi.

Migjeni na kujton se kritika nuk është urrejtje.

Të dy na mësojnë se dashuria për njeriun nuk është vetëm ta përkëdhelësh atë.

Ndonjëherë është ta mbrosh.

Ndonjëherë është t'i shtrish dorën.

Dhe ndonjëherë është t'i thuash shoqërisë një të vërtetë që ajo nuk dëshiron ta dëgjojë.

SHQIPËRIA QË DUHET TË MOS I HARROJË

Popujt nuk maten vetëm me historinë e luftërave, mbretërve, politikës dhe pushteteve.

Popujt maten edhe me njerëzit që kanë ditur t'i japin botës diçka përtej kufijve të tyre.

Nënë Tereza dhe Migjeni janë dy prej tyre.

Njëra e bëri emrin shqiptar të dëgjohej në lagjet më të varfra të Kalkutës, në sallat e diplomacisë botërore, në ceremoninë e Nobelit dhe në Vatikan.

Tjetri e bëri gjuhën shqipe të tingëllojë ndryshe, më e ashpër, më e drejtpërdrejtë, më e shqetësuar, më njerëzore. Të dy e nxorën shqiptarin nga kufijtë e një territori.

Nënë Tereza e çoi identitetin shqiptar në botën e humanizmit. Migjeni e çoi shpirtin shqiptar në botën e letërsisë moderne.

Dhe kjo është një trashëgimi që nuk duhet parë thjesht si krenari kombëtare.

Duhet parë si përgjegjësi. Sepse të nderosh Nënë Terezën nuk do të thotë vetëm të vendosësh emrin e saj në sheshe, aeroporte apo institucione.

Do të thotë të kujdesesh për njeriun që është i vetëm.

Të nderosh Migjenin nuk do të thotë vetëm të botosh veprat e tij. Do të thotë të mos kesh frikë nga e vërteta.

Një shoqëri që e kujton Nënë Terezën, por harron të varfrin, e ka keqkuptuar Nënë Terezën.

Një shoqëri që lexon Migjenin, por nuk dëshiron të shohë mjerimin që ekziston përpara syve të saj, e ka keqkuptuar Migjenin.

Ata nuk janë thjesht figura për monumente. Janë pyetje. Pyetje që na drejtohen edhe sot. Çfarë bëjmë për tjetrin? A kemi ende guximin ta themi të vërtetën?

MË 26 GUSHT, DY KUJTIME PËR NJË KOMB

Ka një ironi të bukur të historisë që të dy emrat lidhen me të njëjtën datë. **Më 26 gusht 1910, lindi një vajzë shqiptare që do të bëhej shenjtore e Kishës Katolike dhe ikonë universale e bamirësisë.**

Më 26 gusht 1938, vdiq një djalë shqiptar i letrave, që do të bëhej një prej zërave më të fuqishëm të letërsisë moderne shqipe.

Njëra lindi për të shërbyer. Tjetri jetoi për të dëshmuar. Njëra na mësoi të mos e braktisim njeriun. Tjetri na mësoi të mos e fshehim të vërtetën. Dhe të dy, secili në mënyrën e vet, e vendosën **njeriun** në qendër. Ndoshta kjo është trashëgimia e tyre më e madhe.

Jo fama.

Jo dekoratat.

Jo monumentet.

Jo titujt.

Por njeriu.

Ai njeri që Nënë Tereza e kërkoi në rrugët e Kalkutës.

Ai njeri që Migjeni e kërkoi në rrugët e Shkodrës.

Ai njeri që vazhdon të ekzistojë edhe sot, mes varfërisë, vetmisë, padrejtësisë, shpresës dhe dëshirës për një jetë më dinjitoze.

Më 4 shtator 2016, në Vatikan, Papa Françesku e shpalli shenjtore Nënë Terezën. Por shenjtërimi i saj nuk ishte fillimi i madhështisë së saj, ishte vetëm njohja zyrtare e një jete që kishte kohë që i përkiste njerëzimit. Migjeni, ndërkohë, nuk pati një altar. Pati letërsinë. Dhe ndoshta nuk i duhej tjetër. Sepse disa njerëz bëhen të pavdekshëm nga besimi. Disa nga vepra. Disa nga sakrifica. Dhe disa nga mënyra se si arrijnë të ndryshojnë përgjithmonë mënyrën tonë të të menduarit.

Nënë Tereza dhe Migjeni janë të tillë.

Dy shqiptarë.

Dy fate.

Dy rrugë krejt të ndryshme.

Por një trashëgimi e përbashkët: të mos kalosh indiferent pranë dhimbjes njerëzore.

Kjo është arsyeja pse, sa herë vjen 26 gushti, nuk duhet të kujtojmë vetëm dy emra.

Duhet të kujtojmë dy mënyra për të qenë njeri.

Dhe ndoshta, mbi të gjitha, duhet të pyesim veten nëse kemi ende kurajën për t'i ndjekur.

FORCA TOKËSORE, 26 VITE NË RRUGËN E TRANSFORMIMIT

Nga riorganizimi i pas viteve '90 te një forcë e konsoliduar, e ndërveprueshme dhe e gatshme për sfidat e së ardhmes

Disa institucione maten me vite, mjaft të tjera maten me gjurmën që lënë në historinë e një vendi. **Forca Tokësore është një prej tyre.**

Një çerek shekulli pas krijimit të saj, Forca Tokësore nuk është më ajo që ishte në ditët e para të gushtit të vitit 2000. Ajo ka kaluar përmes ndryshimeve të thella strukturore, reformave, misioneve, stërvitjeve, sfidave dhe një procesi të pandërprerë profesionalizimi. Nga një strukturë që duhej të ringrihej në një periudhë të vështirë për shtetin dhe Forcat e Armatosura, ajo është shndërruar në një prej shtyllave kryesore të fuqisë mbrojtëse të vendit dhe një kontribuuese e rëndësishme në sigurinë rajonale dhe në kuadër të Aleancës.

Në 26-vjetorin e krijimit, **Gjeneralmajor Petrit Çuni**, komandanti aktual i Forcës Tokësore, e sheh këtë rrugëtim jo thjesht si një histori institucionesh dhe reformash, por si një histori njerëzish, komandantësh, oficerësh, nënoficerësh, ushtarësh dhe specialistësh që, në periudha të ndryshme, kanë mbajtur mbi supe përgjegjësinë për ta çuar përpara këtë Forcë.

Dhe kjo është ndoshta mënyra më e drejtë për ta lexuar historinë e saj.

Një ushtri nuk transformohet vetëm duke ndryshuar strukturën. Ajo transformohet duke ndryshuar kapacitetet, kulturën profesionale dhe mënyrën e të menduarit.

Një histori që nisi në një kohë të vështirë

Më 29 gusht 2000, kur u krijua Forca Tokësore, Shqipëria ndodhej ende nën ndikimin e fortë të trazirave dhe pasojave të vitit 1997. Përpara Forcave të Armatosura qëndronte një proces i vështirë riorganizimi dhe transformimi, ndërsa vendi po përpiqej të afrohej gjithnjë e më shumë me strukturat euroatlantike.

Forca Tokësore u ngrit mbi një trashëgimi të gjerë strukturash dhe njësisish të shpërndara në territorin e vendit. Në momentin e krijimit, ajo përfshinte pesë divizione këmbësorie, rreth 55 brigada dhe 300 batalione, të shtrira në 167 rajone të ndryshme të Shqipërisë.

Por madhësia nuk do të ishte kriteri i së ardhmes.

Kështu nisi një proces transformimi që nuk do të ishte linear dhe as i lehtë. Gjatë këtyre 26 viteve, drejtimin e Forcës Tokësore e kanë marrë përsipër gjeneralë që i përkasin periudhave të ndryshme të këtij transformimi: gjeneralmajor Kostaq Karoli, gjeneralmajor Shpëtim Spahiu, gjeneralmajor Viktor Berdo, gjeneralmajor Zyber Dushku, gjeneralmajor Nazmi Çahani, gjeneral brigade Albert Mullai, gjeneral brigade Arben Kingji, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia dhe aktualisht gjeneralmajor Petrit Çuni.



Secili prej tyre ka drejtuar Forcën në një fazë të ndryshme të zhvillimit të saj. Dhe pikërisht kjo e bën historinë e Forcës Tokësore një histori **vazhdimësie**.

Nga konsumues i sigurisë, në prodhues të sigurisë

Një nga ndryshimet më të mëdha që ka ndodhur gjatë këtij çerek shekulli është vetë koncepti i rolit të Forcës Tokësore. Në vitet e para, prioritet ishte riorganizimi, rikthimi i kapaciteteve dhe përshtatja me kërkesat e reja të sigurisë.

Më pas erdhi profesionalizimi. Pastaj ndërveprueshmëria. Dhe më tej, pjesëmarrja në misione dhe operacione ndërkombëtare.

Sot, Forca Tokësore nuk shihet vetëm si një strukturë që garanton mbrojtjen e territorit kombëtar. Ajo është pjesë aktive e përpjekjeve të përbashkëta për sigurinë, duke kontribuar në operacionet dhe misionet e NATO-s, BE-së dhe OKB-së.

Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO në vitin 2009 ishte një pikë kthese në këtë rrugëtim.

Por anëtarësimi nuk ishte fundi. Ishte fillimi i një standardi të ri. Një standard që kërkonte që Forcat e Armatosura shqiptare të mos ishin vetëm pjesë e Aleancës në aspektin politik, por të ishin të afta të vepronin në mënyrë reale, profesionale dhe të ndërveprueshme me aleatët.

Dhe Forca Tokësore ka ndërtuar një pjesë të rëndësishme të këtij besimi përmes eksperiencës së fituar në terren.

Misionet ndërkombëtare - shkolla e vërtetë e profesionalizmit

Që nga 9 shtatori i vitit 1996, me angazhimin e parë në Bosnje-Hercegovinë, ushtarakët shqiptarë kanë marrë pjesë në një numër të madh misionesh jashtë vendit:

Irak
Afganistan
Bosnje-Hercegovinë
Çad
Gjeorgji
Mali
Sudani i Jugut
Kosovë
Letoni
Bullgari

Këto nuk janë thjesht emra në hartën e botës. Pas tyre qëndrojnë mijëra histori personale. Mijëra ushtarakë. Mijëra ditë larg familjeve. Mijëra orë trajnimi dhe detyra të kryera në kushte të vështira. Sipas të dhënave të përcjella nga Komandanti i Forcës Tokësore, nga shtatori 1996 deri në dhjetor 2024, kontributi i Forcës Tokësore në operacionet ushtarake të drejtuara nga NATO, BE dhe OKB arrin në 7062 personel.

Kjo eksperiencë ka krijuar një kapital profesional që nuk mund të matet vetëm me statistika.

Është eksperiencia e ndërveprimit.

E planëzimit.

E komandimit.

E veprimit në kushte reale.

Dhe Afganistani, në veçanti, mbetet një prej kapitujve më të fortë të kësaj eksperience.

Por ai kapitull ka edhe një faqe të dhimbshme: humbjen e Kapiten Feti Voglit, Dëshmor i Atdheut, sakrifica e të cilit mbetet pjesë e historisë së angazhimit të ushtarakëve shqiptarë në misionet ndërkombëtare.

Sepse çdo histori profesionale e Forcave të Armatosura ka edhe emra që nuk duhen harruar.

Forca që mbron vendin edhe kur kërcënimi nuk vjen nga fusha e betejës

Forca Tokësore ka një tjetër dimension që shpesh nuk shihet në ceremonitë ushtarake: prania pranë qytetarit në kohë fatkeqësish.

Zjarret
Përmbytjet
Tërmetet
Bllokimet nga dëbora
Emergjencat industriale
Pandemia

Në këto situata, uniforma ushtarake është parë në një tjetër mision: jo përballë një armiku, por pranë qytetarit.

Të dhënat e paraqitura nga Forca Tokësore flasin për një angazhim prej 225 277 forcash dhe 18 651 mjetesh në operacionet e emergjencave civile.

Kjo është një tjetër fytyrë e sigurisë.

Një ushtri moderne nuk matet vetëm me aftësinë për të luftuar.

Ajo matet edhe me aftësinë për të shpëtuar, mbështetur dhe mbrojtur.

Prandaj investimi në kapacitetet e emergjencave civile është pjesë e drejtpërdrejtë e konceptit të sigurisë kombëtare.

26 vite transformim, por edhe një ushtri që sheh përpara

Forca Tokësore ka hyrë tashmë në një fazë të re.

Struktura e re organizative, e implementuar duke filluar nga 1 nëntori 2023, synon një forcë më efektive, të kompletuar me personel, të pajisur me armatim dhe teknike të avancuar, të mirë trajnuar dhe të motivuar.

Një prej risive është edhe integrimi i komponentit rezervist krahas personelit aktiv. Kjo nuk është thjesht një ndryshim organizativ. Është një koncept i ri i përdorimit të burimeve njerëzore dhe i rritjes së kapaciteteve në funksion të mjedisit të ri të sigurisë. Por modernizimi nuk ndalet te struktura. Ai shkon te pajisja. Te teknologjia. Te fuqia e zjarrit. Te mbrojtja e trupës. Te lëvizshmëria. Te informacioni. Te aftësia për të marrë vendime më shpejt.

Në këtë kuadër janë parashikuar dhe po zhvillohen projekte për armatim të ri individual dhe kolektiv, sisteme kundër mjeteve fluturuese pa pilot, kapacitete zbulimi dhe vëzhgimi, sisteme **JAVELIN** dhe **STINGER**, sisteme të reja mortajash dhe artilerie, mjete taktike të blinduara **JLTV/APC**, pajisje xheniere, si dhe Sistemi i Menaxhimit të Fushëbetejës.

Në luftën moderne, teknologjia nuk është më një element ndihmës.

Ajo është pjesë e vetë aftësisë luftarake.

NATO, rajoni dhe përgjegjësia për sigurinë

Pozicioni i Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor i jep Forcës Tokësore një rol të rëndësishëm edhe në kontekstin rajonal.

Stabiliteti i Ballkanit Perëndimor mbetet një çështje e rëndësishme për sigurinë evropiane. Në këtë realitet, bashkëpunimi ushtarak nuk është vetëm një instrument teknik.

Është një instrument besimi.

Shqipëria ka plane bashkëpunimi ushtarak me vendet e rajonit, përfshirë Kosovën, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi, si dhe me vende të tjera aleate e partnere.

Stërvitjet e përbashkëta, trajnimet, shkëmbimi i eksperiencës dhe vizitat reciproke krijojnë atë që dokumentet strategjike e quajnë ndërveprueshmëri, por që në terren përkethehet në një fjalë më të thjeshtë:

besim.

Në këtë kuadër, pjesëmarrja në serinë e stërvitjeve “Defender Europe” ka qenë një tjetër provë e rëndësishme.

Shqipëria ka qenë pjesë e kësaj serie në vitet 2021, 2023 dhe 2025, ndërsa në dy edicionet e fundit ka pasur edhe drejtimin e brigadës shumëkombëshe.

Kjo nuk është vetëm një arritje institucionale.

Është një dëshmi e rritjes së kapaciteteve profesionale.

Njeriu mbetet në qendër të modernizimit

Në fund të çdo projekti modernizimi është ushtaraku. Mund të ketë sisteme të reja. Mund të ketë mjete të blinduara. Mund të ketë teknologji moderne.

Por asnjë prej tyre nuk funksionon pa njeriun.

Për këtë arsye, Forca Tokësore e vendos menaxhimin e burimeve njerëzore në qendër të zhvillimit të saj. Trajnimi. Arsimimi. Karriera. Motivimi. Kushtet e punës. Kujdesi shëndetësor. Trajtimi financiar. Mbështetja sociale.

Të gjitha këto janë pjesë e të njëjtit ekuacion: një ushtarak që ndihet i vlerësuar është një ushtarak që mund t'i japë më shumë detyrës.

Nismat për kredi me interes 0% për ushtarakët aktivë dhe punonjësit civilë të Forcave të Armatosura, si dhe rritja e trajtimit financiar me efekt nga 1 janari 2025, janë pjesë e përpjekjeve për një trajtim më dinjitoz të personelit.

Sepse mbrojtja e vendit fillon edhe nga mbrojtja e atyre që e mbrojnë atë.

E ardhmja ka një emër: gatishmëri

Forca Tokësore nuk e sheh të ardhmen si një horizont

të largët. Ajo e ka vendosur atë në një kalendar konkret stërvitjesh, certifikimesh dhe zhvillimi kapacitetesh:

“Mburoja e Arbrit-26”

“Mburoja Ilire-26”

Stërvitjet e KFOR-it

“Mburoja Ilire-27”

“Mburoja Albane-28”

“Mburoja Dardane-29”

Dhe vijimi i pjesëmarrjes në “Defender Europe”

Këto nuk janë thjesht emra stërvitjesh. Ato janë laboratorë ku testohet gatishmëria. Aty ku struktura takohet me realitetin. Aty ku doktrina takohet me terrenin. Aty ku ushtaraku duhet të provojë se ajo që është shkruar në plan funksionon edhe në praktikë. Synimi i deklaruar është i qartë: një Forcë Tokësore e kompletuar, e trajnuar, e stërvitur, e motivuar, e ndërveprueshme dhe e aftë për dislokim e ridislokim brenda dhe jashtë vendit, në përmbushje të misionit kushtetues dhe detyrimeve ndaj NATO-s, BE-së dhe OKB-së.

Një mesazh për brezin që vjen

Në një kohë kur bota po përballet me një mjedis sigurie gjithnjë e më kompleks, mesazhi për të rinjtë është më i rëndësishëm se kurrë.

Shërbimi ushtarak nuk duhet parë vetëm si një profesion.

Ai është një zgjedhje.

Një mënyrë për të ndërtuar karrierë, por edhe për t'i shërbyer një qëllimi më të madh se vetja.

Për Forcën Tokësore, brezi i ri është pjesë e vetë sigurisë së të ardhmes.

Sepse një ushtri moderne nuk mund të ndërtohet vetëm mbi trashëgiminë.

Ajo duhet të ndërtohet mbi brezin që vjen.

Dhe ky brez duhet të sjellë me vete teknologjinë, dijen, energjinë dhe profesionalizmin e kohës së re, duke ruajtur në të njëjtën kohë vlerat që kanë qenë themeli i shërbimit ushtarak: atdhedashurinë, përgjegjësinë, disiplinën dhe sakrificën.

PËRKUSHTIM, PROFESIONALIZËM, DISIPLINË

Nëse 26 vitet e Forcës Tokësore do të duhej të përmbldheshin në tri fjalë, ato tashmë janë thënë: **Përkushtim, Profesionalizëm, Disiplinë.**

Por pas këtyre tri fjalëve fshihet një histori shumë më e gjatë. Historia e mijëra ushtarakëve që kanë shërbyer. E komandantëve që kanë drejtuar. E familjeve që kanë mbështetur. E ushtarëve që kanë shkuar në misione larg atdheut. E atyre që kanë qëndruar në terren në ditë zjarresh, përmbytjesh e tërmetesh. E atyre që kanë dhënë edhe jetën në krye të detyrës. Njëzet e pesë vite janë një çerek shekulli.

Por për një ushtri, ato janë vetëm një kapitull në një histori që vazhdon.

Forca Tokësore e ka nisur këtë histori në një kohë të vështirë. E ka kaluar përmes reformave. E ka provuar veten në misione. E ka ndërtuar besimin me aleatët. Ka hyrë në një proces të ri modernizimi.

Dhe tani qëndron përballë dekadave të ardhshme me një sfidë edhe më të madhe: të jetë gjithmonë një hap përpara mjedisit të sigurisë.

Sepse mbrojtja nuk pret. Kërcënimet nuk paralajmërojnë. Dhe gatishmëria nuk ndërtohet në ditën e krizës. Ajo ndërtohet çdo ditë. Pikërisht aty qëndron edhe kuptimi i 25 viteve të Forcës Tokësore: jo thjesht në atë që është bërë, por në atë që po përgatitet të bëhet.

Një forcë më moderne.

Një forcë më profesionale.

Një forcë më e ndërveprueshme.

Një forcë e gatshme.

Një Forcë Tokësore në shërbim të Shqipërisë, të Aleancës dhe të paqes.

KUR BOTA THA “JO”, NJË MBRET THA “PO”

740 fëmijë në mes të luftës, një anije pa destinacion dhe një njeri që zgjodhi të mos e mbyllte derën

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Historia ka treguar se njerëzimi nuk provohet në fjalime, në traktate apo në paradat e fuqisë. Provohet në një derë. Nëse ajo derë hapet për një njeri të pambrojtur, historia shënon një gjest njerëzor. Nëse mbyllet, mbetet pas saj një heshtje që mund të zgjasë për breza.

Në vitin 1942, në një botë të përfshirë nga Lufta e Dytë Botërore, një anije me 740 fëmijë polakë endet në ujërat e Detit Arabik. Ata nuk janë ushtarë. Nuk kanë armë. Nuk përbëjnë kërcënim për askënd. Janë fëmijë që kanë humbur prindërit, shtëpitë dhe vendin e tyre.

Kanë mbetur gjallë pas një prej kapitujve më të errët të shekullit XX.

Dhe tani kanë nevojë vetëm për një gjë: **Një vend ku të mund të jetojnë.**

Por portat mbyllen. Përgjigjja është “jo”. Përsëri “jo”. Dhe përsëri “jo”.

Në një kohë kur bota kishte gjetur arsye të pafundme për të justifikuar mosndërhyrjen, një njeri vendosi të mos kërkonte asnjë arsye.

Ai pyeti vetëm: **“Sa fëmijë janë?”**

Përgjigjja ishte: **“740.”**

Dhe ai tha: **“Le të vijnë.”**

Ky ishte Jam Sahib Digvijay Singhji, Maharaxhai i Nawanagarit. Dhe kjo është historia e një prej akteve më të jashtëzakonshme të humanizmit gjatë Luftës së Dytë Botërore.

FËMIJËT QË LUFTA UA MORI FËMIJËRINË

Përpara se të mbërrinin në brigjet e Indisë, këta fëmijë kishin kaluar nëpër ferrin e deportimeve sovjetike. Familjet polake ishin shpërngulur me forcë në territore të largëta të Bashkimit Sovjetik. Shumë prej tyre përfunduan në kampe pune, në zona të ashpra ku uria, sëmundjet dhe temperaturat ekstreme shkatërronin trupat. Fëmijët panë prindërit e tyre të dobësoheshin. Panë njerëz të vdisnin. Panë shtëpitë e tyre të zhdukeshin. Dhe shumë prej tyre mbetën vetëm. Në moshën kur një fëmijë duhet të shqetësohet për shkollën, lojërat dhe ditëlindjen e radhës, këta fëmijë mësonin fjalorin e luftës: uri, dëbim, humbje, vdekje.

Ata nuk kishin më një atdhe ku të ktheheshin. Por kishin një shpresë. Të largoheshin. Të gjenin një vend të sigurt. Të jetonin. Përmes Iranit, ata arritën drejt Indisë, duke besuar se më në fund do të gjenin një strehë.

Por lufta kishte krijuar kufij jo vetëm në harta. Kishte krijuar edhe kufij në ndërgjegjen e njerëzve. Autoritetet britanike, të cilat kontrollonin pjesë të mëdha të Indisë, nuk pranuan t'i merrnin nën përgjegjësi. Anija mbeti pa destinacion. Fëmijët prisnin. Dhe ndërsa ditët kalonin, ushqimi pakësohej. Ilaçet bëheshin gjithnjë e më të rralla. Shpresa po bëhej një fjalë e madhe për t'u mbajtur nga duar kaq të vogla.

MARIA DHE PREMTIMI I FUNDIT

Midis tyre mund të imagjinojmë fytyrat e qindra fëmijëve që nuk e kuptonin pse bota nuk kishte vend për ta. Njëra prej tyre ishte Maria, dymbëdhjetë vjeçe. Në krah kishte vëllanë e saj të vogël. Ajo nuk ishte ushtarë. Por lufta e kishte detyruar të bëhej mbrojtëse.

Në kujtesën e saj kishte mbetur zëri i nënës, e cila, në shtratin e vdekjes, i kishte lënë një amanet më të madh se moshja e saj: **“Mbaje të sigurt”.**

Këto katër fjalë mund të jenë bërë për të një mision. Në një botë ku të rriturit kishin dështuar, një vajzë dymbëdhjetëvjeçare përpiqej të mbronte një fëmijë gjashtëvjeçar.



Ajo nuk dinte nëse do të kishte një të nesërme. Por dinte se nuk mund ta lëshonte dorën e vëllait.

Dhe ndoshta pikërisht këtu qëndron tragjedia më e madhe e luftës: ajo i detyron fëmijët të bëhen të rritur përpara kohe.

U merr lodrat.

U merr prindërit.

U merr shtëpinë.

Dhe ndonjëherë u merr edhe besimin se bota është një vend i mirë.

DHE PASTAJ U SHFAQ NJË “PO”

Lajmi për fëmijët arriti te Jam Sahib Digvijay Singhji, Maharaxhai i Nawanagarit. Ai ishte sundimtar i një shteti princëror në Gujarat. Nuk ishte komandant i një ushtrie që mund të ndryshonte rrjedhën e luftës. Nuk ishte president i një fuqie botërore. Nuk kishte përpara vetes një marrëveshje ndërkombëtare që ta detyronte të vepronte.

Mund të kishte thënë: “Nuk është përgjegjësia ime”.

Dhe askush nuk do ta kishte gjykuar me të njëjtën forcë me të cilën e gjykojmë sot.

Por ai nuk e tha.

Kur këshilltarët i treguan për fëmijët, ai nuk pyeti fillimisht sa do të kushtonte.

Nuk pyeti sa do të zgjaste. Nuk pyeti nëse do të kishte pasoja politike.

Pyetja e tij ishte e thjeshtë: **“Sa fëmijë janë?”**

Shtatëqind e dyzet.

Dhe përgjigjja e tij ishte edhe më e thjeshtë: **“Le të vijnë”.**

Në atë çast, një derë u hap. Dhe historia e 740 fëmijëve ndryshoi përgjithmonë.

NJË MBRET QË U UL NË NIVELIN E NJË FËMIJE

Në gusht 1942, fëmijët mbërritën në Nawanagar. Mund të imagjinohet skena.

Një grup fëmijësh të dobësuar nga uria dhe sëmundjet zbret nga anija.

Ata nuk dinë çfarë i pret. Kanë parë autoritete. Kanë parë ushtarë. Kanë parë njerëz që u kanë thënë “jo”. Kanë mësuar se uniforma dhe pushteti nuk do të thonë domosdoshmërisht siguri. Dhe pastaj shohin Maharaxhain. Ai nuk u afrohet si një sundimtar i largët. Ai u afrohet si një njeri. Ulet në nivelin e fëmijëve. I sheh në sy.

Dhe përmes përkthyesit u përcjell mesazhin që për ta do të bëhej një kujtim i përjetshëm: **“Mos e konsideroni veten jetimë. Nga ky moment e tutje, unë jam babai juaj dhe ju jeni fëmijët e mi”.**

Në historinë e luftërave ka shumë fjalime.

Ka urdhra.

Ka deklarata.

Ka kërcënime.

Por ndonjëherë një fjali e thënë pranë një fëmije vlen më



shumë se mijëra fjalë të thëna nga podiumet.

Ai nuk premtoi të ndryshonte botën. Premtoi diçka më konkrete: Të mos i linte ata vetëm.

BALACHADI, VENDI KU FËMIJËT RIKTHYEN EMRIN “SHTËPI”

Në Balachadi u krijua një vendstrehim për fëmijët. Por Maharaxhai kuptoi diçka që shkon përtej ushqimit dhe strehimit. Një fëmijë nuk jeton vetëm me bukë.

Jeton me kujtesën,

Me gjuhën,

Me këngët,

Me historinë e familjes,

Me ndjenjën se i përket diku.

Prandaj fëmijëve iu lejua të ruanin identitetin e tyre polak.

U siguruan mësues polakë,

U ruajt gjuha,

U respektua feja,

U ruajtën traditat.

U përgatitën ushqime që u kujtonin atdheun. Dhe kur erdhën Krishtlindjet, në tokën e nxehtë indiane, fëmijët mundën të festonin sipas traditave të tyre.

Kjo ishte më shumë se një strehë.

Ishte një përpjekje për t’u kthyer fëmijëve atë që lufta ua kishte marrë: normalitetin.

Sepse humanizmi nuk është vetëm të shpëtosh një njeri nga vdekja. Është edhe t’i kthesh atij të drejtën për të jetuar me dinjitet.

NJË USHTRI QË NUK MBAJTI ARMË

Ka një paradoks të fuqishëm në këtë histori. Në vitin 1942, bota fliste për ushtri, tanke, avionë, anije dhe frontet e luftës. Por në Balachadi, një nga betejat më të rëndësishme u zhvillua

pa armë. Beteja ishte kundër harresës.

Kundër indiferencës. Kundër idesë se një njeri mund të bëhet “problem” vetëm sepse ka nevojë për ndihmë.

Maharaxhai përdori atë që kishte në dispozicion: pasurinë, autoritetin dhe ndikimin e tij. Por arma e tij kryesore ishte tjetër:

ndërgjegjja. Ai nuk mund ta ndalte luftën. Por mund të ndalte një pjesë të vogël të saj. Mund të mbronte 740 fëmijë. Dhe ndonjëherë historia nuk kërkon nga një njeri të shpëtojë gjithë botën. I kërkon të shpëtojë ata që ka përpara.

KATËR VJET QË NDRYSHUAN 740 JETË

Për vite me radhë, fëmijët jetuan në Balachadi. Mjekët u kujdesën për ta. Ushqimi u sigurua. Fëmijët vazhduan shkollimin.

Luajtën. Mësuan. U rritën. Disa filluan përsëri të qeshnin. Kjo është ndoshta fitorja më e madhe e atij vendi. Jo vetëm se fëmijët mbijetuan. Por sepse filluan të jetonin. Pas gjithë asaj që kishin parë, ata mësuan përsëri të besonin te të rriturit. Mësuan se një derë mund të hapet. Se një njeri mund të thotë “po”. Se një i panjohur mund të bëhet familje. Dhe se edhe në kohën më të errët, mirësia nuk është një dobësi. Është forcë.

KUR FËMIJËT IKËN

Lufta përfundoi. Por për këta fëmijë, fundi i luftës nuk do të thoshte domosdoshmërisht kthim në shtëpi. Polonia e tyre kishte ndryshuar. Jeta e tyre kishte ndryshuar. Ata ishin rritur.

Dhe tani duhej të largoheshin nga vendi që për shumë vite kishte qenë shtëpia e tyre.

Shumë prej tyre qanë. Sepse po linin pas një njeri që nuk ishte babai i tyre biologjik, por që kishte bërë diçka që vetëm një baba do ta bënte: i kishte mbrojtur kur askush tjetër nuk donte t’i merrte përsipër. Ata u shpërndanë në vende të ndryshme. Disa u bënë mjekë. Disa inxhinierë. Disa profesionistë të fushave të ndryshme.

U martuan.

Patën fëmijë.

U bënë gjyshër.

Por Balachadi mbeti në kujtesën e tyre si vendi ku fëmijëria e tyre u kthye nga një kujtim lufte në një kujtim shprese.

EMRI QË POLONIA NUK E HARROI

Historia e Maharaxhait nuk përfundoi kur fëmijët u larguan. Në Poloni, kujtimi i tij vazhdoi të jetojë. Institucione, shkolla dhe hapësira publike kanë ruajtur emrin e tij. Për shumë polakë, ai nuk është thjesht një sundimtar indian nga një epokë e largët. Ai është njeriu që, në një nga momentet më të vështira të historisë së tyre, nuk pyeti se çfarë kombësie kishin fëmijët. Pyeti vetëm nëse kishin nevojë për ndihmë. Dhe përgjigjja e tij ishte po. Kjo është arsyeja pse kujtimi i tij ka kapërcyer kufijtë e Indisë. Sepse mirësia nuk ka kombësi.

MËSIMI QË MBETET PËR USHTARIN DHE PËR NJERIUN

Për një gazetë që mban emrin “Ushtria”, kjo histori ka një kuptim të veçantë.

Sepse ushtria nuk është vetëm një institucion i armëve.

Në kuptimin më të lartë të fjalës, ajo lidhet me mbrojtjen.

Mbrojtja e territorit.

Mbrojtja e qytetarëve.

Mbrojtja e jetës.

Mbrojtja e dinjitetit.

Historia e 740 fëmijëve polakë na kujton se koncepti i mbrojtjes nuk fillon dhe nuk përfundon në fushën e betejës.

Ka edhe beteja morale. Ka momente kur uniforma nuk të kërkon vetëm disiplinë, por karakter. Ka raste kur autoriteti nuk matet me fuqinë për të urdhëruar, por me gatishmërinë për të mbrojtur atë që nuk mund të mbrohet vetë. Maharaxhai nuk ishte ushtar në atë moment. Por veprimi i tij

kishte një nga cilësitë më të larta të një mbrojtësi: përgjegjësinë për jetën e tjetrit.

FUQIA E NJË “PO”-JE

Historia është plot me njerëz që thanë “jo”.

“Jo, nuk mundemi”

“Jo, nuk është përgjegjësia jonë”

“Jo, nuk kemi burime”

“Jo, nuk kemi vend”

“Jo, nuk mund të rrezikojmë”

Këto “jo” janë shpesh të arsyeshme.

Por historia mbahet mend për ata që, në një moment vendimtar, gjetën forcën të thoshin: “Po.”

Po, do t’ju pranojmë

Po, do t’ju ushqejmë

Po, do t’ju shkollojmë

Po, do t’ju mbrojmë

Po, do t’ju japim një shtëpi

Po, edhe pse nuk jeni fëmijët tanë, do të sillemi me ju sikur të ishit.

Ky është thelbi i humanizmit.

Jo të bësh mirë kur është e lehtë.

Por të bësh mirë kur është e vështirë.

NJË MBRETËRI MUND TË HARROHET,

NJË MIRËSI JO

Sot, shumë nga mbretëritë dhe kufijtë politikë të asaj kohe nuk ekzistojnë më në të njëjtën formë. Fuqitë ndryshojnë. Qeveritë bien. Perandoritë zhduken. Hartat rishkruhen. Por një fëmijë që dikur mendonte se nuk kishte më shtëpi mund të kujtojë për gjithë jetën njeriun që i hapi derën. Kjo është një formë tjetër e pavdekësisë.

Jo ajo e monumenteve.

Jo ajo e pasurisë.

Jo ajo e pushtetit.

Por ajo e kujtesës njerëzore.

Sepse njeriu mund të humbasë fronin.

Mund të humbasë titullin.

Mund të humbasë pasurinë. Por nëse ka shpëtuar një jetë, ajo jetë bëhet dëshmitare e tij. Nëse ka shpëtuar 740 jetë, atëherë historia nuk mund ta harrojë lehtë.

EPILOG

Në vitin 1942, 740 fëmijë polakë ishin të humbur në një botë që po digjej.

Ata nuk kërkonin pushtet. Nuk kërkonin privilegje. Nuk kërkonin një mbretëri. Kërkonin vetëm të mos vdisnin. Dhe kur shumë dyer u mbyllën, njëra u hap.

Pas saj ishte një njeri. Një Maharaxha. Një udhëheqës. Por mbi të gjitha, një njeri që kuptoi diçka të thjeshtë: **fëmijët nuk kanë nevojë të kenë të njëjtën pasaportë për të merituar mbrojtjen.**

Ai nuk mund ta ndryshonte historinë e luftës. Por ndryshoi historinë e 740 fëmijëve. Dhe ndoshta kjo është mënyra më e vërtetë për ta matur madhësitinë e një njeriu. Jo me numrin e njerëzve që i binden. Por me numrin e njerëzve që mund të jetojnë sepse ai zgjodhi të mos largohej.

Sot, kur bota përsëri përballet me luftëra, refugjatë, fëmijë të zhvendosur dhe njerëz që kërkojnë një derë të hapur, historia e Balachadit nuk është thjesht një kujtim i së kaluarës.

Është një pyetje për të tashmen: **Çfarë bëjmë ne, kur një fëmijë është duke kërkuar strehë?**

A shohim nga ana tjetër?

A gjejmë një arsye për të thënë “jo”?

Apo gjejmë kurajën për të thënë: **“Le të hyjë.”**

Sepse fuqia e një njeriu nuk matet me atë që mund të marrë nga bota. Matet me atë që është i gatshëm t’i japë asaj.

Dhe historia e 740 fëmijëve polakë na kujton një të vërtetë që nuk ka nevojë për ushtri, kufj apo flamuj: **Fuqia nuk matet me tokat që pushton, por me jetët që mbron.**

Dhe ndonjëherë, akti më i madh i rebelimit ndaj një bote të pamëshirshme është thjesht të mos bëhesh pjesë e pamëshirshmërisë së saj.

Të hapësh derën.

Të shtrish dorën.

Të thuash “po”.

Sepse një mbretëri mund të harrohet.

Një fron mund të zhduket.

Por një fëmijë që u shpëtua nuk e harron kurrë njeriun që i dha një shtëpi.

GRUA, MOS E VISH VETEN ME ÇMIMIN E NJË ETIKETE

Bukuria nuk blihet, ajo lind nga mënyra si e njeh, e respekton dhe e mban veten

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Gruaja nuk bëhet e bukur nga ajo që vesh,
por nga mënyra se si e mban veten

Ekziston një gënjeshtër e bukur që moda na e përsërit çdo ditë: se bukuria mund të blihet. Na bind se një emër i famshëm mbi një çantë, një logo mbi një palë këpucë, një fustan i kushtueshëm apo një aksesor i fundit mund të na japë atë që në të vërtetë nuk shitet në asnjë dyqan: vetëbesimin.

Na kanë mësuar të besojmë se duhet të ndjekim tendencat për të qenë moderne, të blejmë më shumë për t'u dukur më mirë dhe të veshim marka për të fituar vëmendjen e të tjerëve.

Por moda është vetëm sipërfaqja.

Nën të qëndron gruaja.

Dhe është ajo që i jep kuptim çdo rrobe.

Një fustan i shtrenjtë mund të kushtojë mijëra euro dhe të mos thotë asgjë. Një fustan i thjeshtë mund të mos ketë asnjë logo dhe të mbajë brenda vetes një histori të tërë. Sepse ajo që e bën një grua të paharrueshme nuk është çmimi i veshjes, por mënyra se si ajo ecën, si buzëqesh, si komunikon, si qëndron përballë botës dhe, mbi të gjitha, si ndihet me veten.

Këtu fillon stili.

Dhe këtu përfundon mashtrimi i modës.

Bukuria nuk ka etiketë

Ka gra që hyjnë në një sallë dhe askush nuk pyet çfarë kanë veshur.

Njerëzit thjesht i shohin.

Jo sepse janë domosdoshmërisht të veshura me luks, por sepse kanë diçka që nuk mund të blihet: prani.

Prania është ajo forcë e heshtur që nuk ka nevojë të bëjë zhurmë.

Një grua që ndihet mirë me veten nuk ka nevojë të kërkojë miratim në çdo pasqyrë. Ajo nuk vishet për t'u krahasuar. Nuk ecën për të konkurruar. Nuk buzëqesh për të bindur dikë se është e lumtur.

Ajo thjesht është.

Dhe pikërisht kjo e bën të bukur.

Sepse bukuria më e fortë nuk është ajo që kërkon të shihet. Është ajo që **nuk ka nevojë të kërkojë vëmendje**.

Në një kohë kur rrjetet sociale kanë krijuar një industri të tërë të pamjes perfekte, kjo është ndoshta një nga të vërtetat më të rëndësishme që duhet t'ia themi gruas së sotme:

Nuk ke pse të jesh perfekte për të qenë e bukur.

Nuk ke pse të kesh trupin e një modeleje.

Nuk ke pse të veshësh çdo sezon atë që dikush tjetër ka vendosur se është në modë.

Nuk ke pse të ndryshosh veten për t'iu përshtatur një standardi që ndryshon çdo gjashtë muaj.

Duhet të dish vetëm një gjë: **kush je**.

Sepse kur një grua e njeh vlerën e saj, ajo nuk e mat veten me çmimin e rrobave.



Fustani nuk e krijon gruan

Një fustan mund të jetë i bukur. Mund të jetë elegant, modern, i kushtueshëm. Por fustani nuk ecën vetë. Është gruaja që e mbush atë me karakter.

Një veshje mund të tregojë shije, por nuk mund të tregojë të gjithë një grua.

Ajo që tregon një grua është mënyra si sillet me njerëzit, mënyra si përballon vështirësitë, mënyra si ngrihet pas një zhgënjimi, mënyra si kujdeset për familjen, mënyra si punon, si lufton për ëndrrat e saj dhe si ruan dinjitetin edhe kur jeta nuk i ka dhënë gjithmonë atë që ka kërkuar.

Kjo është moda që nuk del kurrë nga moda.

Dinjiteti.

Mirësia.

Inteligjenca.

Eleganca.

Vetëbesimi.

Karakteri.

Këto janë aksesoret e vërtetë të një gruaje. Dhe nuk kanë çmim.

Një grua nuk duhet të vishet për botën

Ndoshta një nga gabimet më të mëdha që i kemi mësuar grave është të mendojnë gjithmonë se si do të duken në sytë e të tjerëve.

“Si do të më shohin?”

“Çfarë do të thonë?”, “A më shkon?”, “A jam mjaftueshëm elegante?”, “A jam më e bukur se ajo?”.

Pyetje të tilla e kthejnë veshjen në një provim të përditshëm.

Por gruaja nuk duhet të jetojë për t’u vlerësuar nga një publik.

Ajo duhet të vishet për veten e saj. Nëse dëshiron taka, le t’i veshë. Nëse dëshiron atlete, le të ecë me to. Nëse i pëlqen një fustan i kuq, le ta veshë të kuqin. Nëse ndihet më mirë me një këmishë të bardhë dhe një palë xhinse, le të jetë pikërisht ajo. Sepse stili personal fillon në momentin kur pushon së kopjuari të tjerët.

Moda thotë: **“Bëhu siç është tendenca”**.

Stili thotë: **“Bëhu siç je ti”**.

Dhe mes këtyre dy fjalive qëndron një ndryshim i madh.

Gruaja që nuk kërkon leje për të qenë vetvetja

Ka një moshë në jetën e një gruaje kur ajo kupton diçka të rëndësishme: nuk mund ta kalojë gjithë jetën duke u përpjekur t’u pëlqejë të tjerëve. Në një moment, ajo fillon të zgjedhë. Jo më atë që i thonë. Por atë që i përshtatet.

Jo më atë që është “në modë”. Por atë që e bën të ndihet mirë. Jo më atë që i pëlqen turmës. Por atë që i pëlqen asaj. Dhe ky është një nga momentet më të bukura të një gruaje. Sepse aty lind eleganca e vërtetë.

Nuk është më çështje moshe. Nuk është çështje trupi. Nuk është çështje markash. Është çështje vetëdijeje. Një grua që ka mësuar të pranojë veten nuk ka nevojë të luftojë me pasqyrën. Ajo e sheh veten me gjithë historinë që mbart.

Me vitet.

Me rrudhat.

Me kujtimet.

Me fitoret.

Me humbjet.

Me plagët që askush nuk i sheh.

Dhe thotë: *“Kjo jam unë”*. Ndoshta ky është kombinimi më elegant që mund të veshë një grua.

Pasqyra nuk duhet të jetë gjykatë

Sa gra janë zgjuar në mëngjes dhe kanë parë në pasqyrë jo atë që janë, por atë që mendojnë se duhet të ishin? Një kilogram më shumë. Një rrudhë më tepër.

Një shenjë në fytyrë. Një flok i bardhë. Një trup që nuk është më ai i njëzetave.

Dhe menjëherë fillon gjykimi. Por trupi i një gruaje nuk është armiku i saj.

Trupi është dëshmitari i jetës së saj.

Ai ka kaluar net pa gjumë.

Ka përballuar lodhje.

Ka sjellë jetë.

Ka punuar.

Ka udhëtuar.

Ka qarë.

Ka qeshur.

Ka përballuar dhimbje.

Ka mbajtur mbi vete vite të tëra historie.

Prandaj ndoshta duhet të mësojmë të mos e shohim pasqyrën si gjykatë. Ta shohim si një kujtesë. Një kujtesë se kemi ardhur deri këtu. Dhe se kjo, në vetvete, është bukur.

Moda ndryshon. Gruaja mbetet.

Çdo sezon sjell një trend të ri. Një ngjyrë. Një prerje. Një model. Një siluetë. Një markë. Dje ishte një gjë. Sot është një tjetër. Nesër do të jetë diçka krejt ndryshe. Moda jeton sepse ndryshon. Por gruaja nuk mund të ndryshojë çdo ditë vetëm për të qenë “në trend”. Ajo ka nevojë për diçka më të qëndrueshme.

Stilin e saj. Stili është kujtesë. Është identitet. Është mënyra se si një grua zgjedh të paraqitet pa humbur veten.

Prandaj një grua elegante nuk është domosdoshmërisht ajo që ka gardërobën më të madhe.

Është ajo që di të zgjedhë.

Di çfarë i shkon. Di çfarë nuk i shkon. Di kur duhet të jetë ekstravagante. Di kur duhet të jetë e thjeshtë. Dhe mbi të gjitha, **nuk lejon që veshja të flasë më shumë se karakteri**.

Luksi më i madh është të ndihesh mirë me veten

Në një botë ku gjithçka ka një çmim, ne kemi harruar se disa nga gjërat më të çmuara nuk shiten. *Nuk blihet qetësia. Nuk blihet vetëbesimi. Nuk blihet karakteri. Nuk blihet një buzëqeshje e singertë. Nuk blihet respekti. Nuk blihet dinjiteti.*

Dhe nuk blihet ajo energji që e bën një grua të hyjë në një dhomë dhe ta ndryshojë atmosferën pa thënë asnjë fjalë. Prandaj luksi i vërtetë nuk është të kesh gjithçka. Është të mos kesh nevojë për gjithçka për t’u ndier e plotë.

Një grua që e di këtë është e lirë. Ajo mund të blejë një çantë të shtrenjtë, por nuk është rob i saj.

Mund të veshë një fustan të markës, por nuk e përdor markën për të krijuar identitetin e saj.

Mund të ndjekë modën, por nuk humbet pas saj.

Ajo e përdor modën.

Nuk lejon që moda ta përdorë atë.

Të kujdesesh për veten nuk është vanitet

Ka edhe një keqkuptim tjetër që duhet ta rrëzojmë. Të kujdesesh për veten nuk do të thotë të jesh sipërfaqësore.

Një grua ka të drejtë të kujdeset për flokët e saj.

Të kujdeset për lëkurën. Të zgjedhë një parfum. Të blejë një fustan që e bën të lumtur. Të merret me trupin e saj. Të zbukurohet. Të ndryshojë modelin e flokëve. Të eksperimentojë me modën. Të gjitha këto nuk janë domosdoshmërisht shenja vaniteti.

Mund të jenë mënyra për t’i thënë vetes: “Unë vlej.”

Por ekziston një vijë e hollë. Kujdesi për veten është dashuri. Varësia nga miratimi i të tjerëve është pasiguri. Dhe një grua duhet të mësojë t’i dallojë këto të dyja. Sepse nuk është e njëjta gjë të zbukurohesh sepse e do veten dhe të zbukurohesh sepse ke frikë se nuk je mjaftueshëm e bukur.

Vajzave duhet t’u mësojmë diçka tjetër

Ndoshta mesazhi më i madh i kësaj historie nuk është vetëm për gratë.

Është edhe për vajzat që po rriten sot.

Vajzat që shohin çdo ditë në ekran trupa të përsosur, fytyra të filtruara, jetë të kuruara dhe një botë ku duket sikur të gjithë janë të bukur, të lumtur dhe të suksesshëm.

Atyre duhet t’u themi: Mos e mat vlerën tënde me numrin e pëlqimeve. Mos e mat bukurinë me një filtër. Mos mendo se një logo të bën më të rëndësishme. Mos mendo se duhet të dukesh si dikush tjetër për të qenë e bukur. Mëso të lexosh. Mëso të mendosh. Mëso të punosh. Mëso të thuash “jo”. Mëso të respektosh veten. Mëso të largohesh nga vendet ku nuk të respektojnë. Mëso të duash pa humbur veten. Mëso të jesh e fortë pa u bërë e ashpër. Mëso të jesh e butë pa u bërë e dobët. Dhe kur të vishesh bukur, bëje sepse të pëlqen. Jo sepse ke frikë se nuk do të të pëlqejnë.

Kjo është një diferencë që mund t’ua ndryshojë jetën.

Eleganca fillon aty ku mbaron nevoja për t’u dukur

Ka gra që nuk kanë nevojë të flasin shumë. Nuk kanë nevojë të tregojnë sa kushton fustani. Nuk kanë nevojë të tregojnë markën e çantës. Nuk kanë nevojë të tregojnë se ku e kanë blerë.

Sepse eleganca nuk bërtet. Eleganca pëshpërit.

Ajo është në mënyrën si një grua i drejtohet një të moshuari. Në mënyrën si dëgjon. Në mënyrën si falënderon. Në mënyrën si largohet pa poshtëruar askënd.

Në mënyrën si sillet me dikë që nuk ka asgjë për t’i ofruar. Sepse është shumë e lehtë të jesh e sjellshme me njerëzit që mund të të japin diçka. Karakteri duket kur je e sjellshme me ata që nuk mund të të japin asgjë.

Aty matet një grua. Jo në pasarelë. Jo në Instagram. Jo në vitrinë. Por në jetën e përditshme.

Një grua e bukur nuk është ajo që të gjithë e shohin

Është ajo që, pasi e ke takuar, të mbetet në mendje.

Mund të mos kujtosh fustanin. Mund të mos kujtosh këpucët. Mund të mos kujtosh çantën. Por kujton mënyrën si të bëri të ndiheshe. Kjo është bukuria që zgjat. Dhe kjo është arsyeja pse disa gra bëhen më të bukura me kalimin e viteve.

Jo sepse koha i ka kursyer. Por sepse koha u ka dhënë thellësi. Një grua që ka jetuar, ka dashur, ka humbur, ka luftuar dhe është ringritur ka një bukuri që nuk mund ta krijojë asnjë filtër.

Ajo ka një dritë tjetër. Një qetësi tjetër. Një shikim tjetër.

Dhe në atë shikim ka histori.

Vlera e gruas nuk matet me pamjen

Duhet ta themi qartë, sidomos në një kohë kur gratë shpesh gjykoohen së pari nga pamja: *Gruaja është shumë më tepër se trupi i saj. Ajo është mendja e saj.*

Është zemra. Është puna. Është inteligjenca. Është kuraja. Është dashuria.

Është përkushtimi. Është aftësia për të filluar përsëri.

Është mënyra si përballon jetën. Është ajo që ndërton. Është ajo që lë pas.

Një grua mund të jetë nënë, bashkëshorte, profesioniste, artiste, sipërmarrëse, ushtarake, mjeke, mësuese, gazetare, sportiste apo drejtuese.

Dhe në secilin prej këtyre roleve ajo ka një identitet që nuk mund të përmblidhet në një veshje.

Prandaj moda duhet të jetë shprehje e gruas, jo përkufizim i saj.

VISHU BUKUR, POR MOS E HARRO VETEN

Në fund, ndoshta ky është mesazhi më i thjeshtë dhe më i madh që mund t’i japim çdo gruaje: Vishu bukur. Përdor ngjyrat që të pëlqejnë. Eksperimentoni me stilin. Bli atë që mundesh dhe atë që të bën të lumtur. Kujdesu për trupin. Kujdesu për fytyrën. Kujdesu për flokët.

Qesh. Ec drejt. Mbaje kokën lart. *Por mos e harro veten. Mos e lër një etiketë të përcaktojë vlerën tënde. Mos e lër një pasqyrë të vendosë sa vlen. Mos e lër një koment në rrjetet sociale të të prishë ditën. Mos e lër moshën të të bindë se bukuria ka një afat skadence. Mos e lër modën të të bindë se duhet të jesh dikush tjetër. Sepse ti nuk je veshja që ke veshur. Ti je gruaja që e vesh atë. Dhe kjo është e gjithë diferenca.*

SEPSE STILI I VËRTETË NUK BLIHET

Moda mund të të japë një fustan. Stili të jep identitet. Moda mund të të japë një palë këpucë. Eleganca të mëson si të ecësh.

Moda mund të të japë një çantë. Karakteri të mëson çfarë të mbash brenda saj.

Moda mund të të japë një pasqyrë. Vetëbesimi të mëson si të shohësh veten.

Dhe pikërisht këtu mbyllet mashtrimi i bukur i modës.

Sepse ajo që duket si një histori për rrobat është, në të vërtetë, një histori për vlerën e gruas.

Një grua mund të ketë pak, mund të ketë shumë, mund të veshë markën më të shtrenjtë të botës ose një fustan të thjeshtë të blerë vite më parë.

Por nëse ajo hyn në jetë me dinjitet, me dashuri për veten, me inteligjencë, me karakter dhe me atë sigurinë e qetë që nuk kërkon leje për të ekzistuar, atëherë ajo ka veshur diçka që nuk del kurrë nga moda: veten e saj.

Dhe ndoshta kjo është veshja më e shtrenjtë që mund të ketë një grua.

Jo sepse kushton shumë.

Por sepse nuk ka çmim.

Moda ndryshon,

Trendet kalojnë,

Markat vjetrohen,

Fustanet dalin nga moda,

Por një grua që e di vlerën e saj...

nuk del kurrë nga moda.

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Nga financiere e ushtrisë në Korçë te poetja që ruan
në vargje një brez grash në uniformë

Me përfundimin e shërbimit, njerëzit e lenë uniformën në gardërobe. Ka edhe të tjerë që, edhe pasi dalin në rezervë, vazhdojnë ta mbajnë atë brenda vetes. Jo si një veshje të së shkuarës, por si një kujtesë, si një mënyrë të menduari, si një pjesë të pandashme të jetës.

Vasilika Babo-Topi është një prej tyre. Oficere financiere, intelektuale, poete dhe publiciste, ajo i përket një brezi grash që e jetuan ushtrinë në një kohë tjetër, me disiplinën e saj, vështirësitë, sakrificat, por edhe me miqësitë dhe lidhjet njerëzore që, sipas saj, mbetën të forta edhe shumë vite pas largimit nga uniforma.

E lindur në Korçë, më 29 gusht 1949, është një nga gratë që i përket historisë së një brezi të veçantë të grave ushtarake shqiptare. Pas përfundimit të shkollës së mesme në qytetin e lindjes, asaj iu dha e drejta për të ndjekur studimet e larta në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha”, në degën e Financës.

Studimet i përfundoi gjatë viteve **1970–1973**, duke nisur më pas një karrierë të gjatë në Forcat e Armatosura. Për 23 vite me radhë shërbeu në garnizonin e Korçës si oficere financiere. Me gradën **Kapiten i Parë**, në vitin 1992 doli në rezervë, në kuadër të reformës në Forcat e Armatosura.

Por historia e Vasilika Babos nuk përfundon me daljen në rezervë.

Përkundrazi, aty nis një tjetër rrugëtim.

NGA LETËRSIA TE UNIFORMA

Rruga drejt profesionit ushtarak nuk ishte domosdoshmërisht rruga që ajo kishte menduar në fillim.

Asaj i ishte dhënë e drejta për të ndjekur studimet në gjuhë-letërsi. Vajzë e qetë, e matur dhe e tërhequr nga arti, ajo nuk e kishte imagjinuar veten menjëherë në një profesion që kërkonte disiplinë ushtarake, stërvitje dhe një jetë të lidhur me uniformën.

Ishte babai i saj ai që ndikoi në zgjedhjen e kësaj rruge. Ai e shihte profesionin e ushtarakut si një profesion të veçantë, veçanërisht për një vajzë, dhe e orientoi drejt shkollës ushtarake. Vasilika e pranoi sfidën dhe e përfundoi atë me rezultate të larta.

Kështu, një vajzë e lidhur me artin dhe letërsinë do të gjente veten në botën e uniformës.

Dhe pikërisht ky kontrast do të bëhej më vonë një nga veçoritë më interesante të portretit të saj.

Oficere në shërbim, poete në shpirt.

VITET E UNIFORMËS

Jeta ushtarake e Vasilika Babos u shtri në disa struktura të rëndësishme të garnizonit të Korçës.

Ajo shërbeu si shefe finance **në Brigadën e 8-të të Këmbëorisë, Brigadën e Artilerisë në Mborje, Brigadën e Këmbëorisë në Drenovë dhe Brigadën e Tankeve në Pocest, duke mbajtur gradën e kapitenes.**

Pas këtyre detyrave qëndronte një realitet i tërë i jetës ushtarake. Stërvitjet, marshimet, disiplina, ditët e gjata, terreni, uniforma dhe përgjegjësia profesionale ishin pjesë e përditshmërisë së saj.

Kujtimet e saj sjellin pamje nga vitet e shkollës ushtarake, marshimet në Dajt, pajisjet ushtarake, kundërgazi, armatimi, qëndrimet në tunele gjatë ditëve të ftohta të dimrit dhe ritmi i jetës së vajzave që kishin zgjedhur uniformën.

Por në gjithë këtë vështirësi, mbizotëron një ndjenjë e fortë përkatësie.

Për brezin që ajo përfaqëson, ushtria ishte edhe një shkollë e marrëdhënieve njerëzore. Miqësitë e krijuara në ato vite, sipas kujtimeve të saj, mbetën të gjalla edhe pasi jeta i shpërndau koleget në vende të ndryshme të botës.

GRUAJA NË UNIFORMË

Historia e Vasilika Babos është edhe historia e një brezi



grash që zgjodhën një profesion jo të zakonshëm për kohën.

Ato ishin vajza që hynë në shkollën ushtarake, veshën uniformën dhe u përballën me të njëjtat kërkesa disiplinore dhe profesionale si kolegët e tyre meshkuj.

Vasilika i kujton me respekt të veçantë koleget e saj, sidomos ato që shërbyen në këmbësori dhe ndërlidhje, duke vlerësuar vështirësitë dhe sakrificat e tyre.

Në kujtesën e saj, ato gra nuk shfaqen vetëm si ushtarake. Ato shfaqen si vajza që u rritën së bashku, që ndanë vështirësitë, këngët, marshimet dhe ëndrrat e rinisë.

Një brez që, edhe pse jeta më pas e shpërndau në drejtime të ndryshme, vazhdoi të ruajë lidhjen me njëra-tjetrën.

NJË FAMILJE ME DY UNIFORMA

Në jetën e Vasilika Babos, uniforma nuk ishte vetëm pjesë e karrierës së saj.

Ajo ishte pjesë edhe e jetës familjare.

Bashkëshorti i saj, Roberti, ishte gjithashtu ushtarak. Pas emërimeve të ndryshme në shkolla, kompani dhe brigada, ai arriti të shërbente si shef Shtabi i Divizionit në Korçë me gradën kolonel.

Ishte një familje ku shërbimi ushtarak ishte pjesë e përditshmërisë. Dy njerëz në uniformë, me përgjegjësitë e profesionit dhe familjes, me të njëjtën disiplinë dhe me një jetë të ndërtuar rreth detyrës. Më pas erdhi tranzicioni dhe mërgimi.

Vitet e jetës në Greqi sollën vështirësi dhe sakrifica. Fëmijët u shpërndanë në vende të ndryshme dhe familja u përball me atë realitet të ri që preku shumë familje shqiptare pas viteve '90.

KUR DHIMBJA U KTHYE NË VARGJE

Pikërisht në vitet e mërgimit, poezia mori një dimension tjetër në jetën e Vasilika Babos.

Humbjet familjare, largimi i fëmijëve dhe dhimbja e kurbetit u kthyen në temë të shkrimeve të saj.

Ajo ka shkruar dy libra me poezi dhe një tjetër me kujtime e pjesë nga jeta në mërgim, duke trajtuar në shkrimet e saj edhe dhimbjen e nënave shqiptare dhe plagët e kurbetit.

Kështu, oficerja e financës gjeti një tjetër mënyrë për të komunikuar me botën.

Nëse gjatë viteve të uniformës dokumentonte shifra dhe përgjegjësi profesionale, në vitet e mëvonshme ajo nisi të dokumentojë ndjenja, kujtime dhe histori njerëzore.

“NUSËRIA E BLERTË”

Një nga dëshmitë më të veçanta të lidhjes së saj me gratë ushtarake është poezia **“Nusëria e blertë...”**.

Në të, uniforma ushtarake shndërrohet në simbol të rinisë së vajzave që zgjodhën shërbimin.

Uniforma e gjelbër vendoset përballë fustanit të bardhë të nusërisë. Pushka, gjerdani, rreshtat dhe marshimi bashkohen me ëndrrat e vajzave për dashurinë dhe familjen.

Poezia përcjell edhe një dhimbje të heshtur, atë të nënave që nuk i panë vajzat e tyre nuse dhe të një

rinie që u kushtua detyrës.

Në këtë mënyrë, poezia bëhet një dokument emocional për një brez grash në uniformë.

KUJTESA SI NJË TJETËR FORMË SHËRMBIMI

Vasilika Babo sot mbetet e lidhur me historinë dhe kujtesën e Forcave të Armatosura.

Edhe pas daljes në pension, ajo ka vijuar të përcjellë vlerat, traditat dhe përvojat e ushtrisë shqiptare.

Në kuadër të 30-vjetorit të SHKURSH, ajo u nderua me **“Certifikatën e Mirënjohjes”**, të dhuruar nga ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nuhi, në vlerësim të kontributit të saj në transmetimin dhe ruajtjen e këtyre vlerave. Është një vlerësim që përputhet me rrugëtimin e saj.

Sepse shërbimi nuk ka përfunduar me uniformën. Ai ka marrë një tjetër formë.

Kujtesën.

Përmes librave, poezive dhe shkrimeve, Vasilika Babo ka zgjedhur të ruajë një pjesë të historisë së një brezi që nuk dëshiron të harrohet.

NJË PORTRET QË MBETET

Në portretin e **Vasilika Babos** bashkohen disa dimensione. Është oficerja, e cila për më shumë se dy dekada shërbeu në strukturat e Forcave të Armatosura.

Është gruaja në uniformë, pjesë e një brezi që sfidoi kufijtë e kohës për të ndërtuar karrierën e vet ushtarake.

Është bashkëshortja dhe nëna, që e përjeto i edhe dhimbjen e emigrimit dhe largimit të fëmijëve.

Është poetja, që e ktheu dhimbjen dhe kujtesën në vargje. Dhe është mbi të gjitha dëshmitarja e një kohe.

Një grua që sot, shumë vite pas shërbimit aktiv, vazhdon të flasë për ushtrinë, për koleget, për sakrificat dhe për vlerat që ajo mendon se duhet të ruhen nga një brez te tjetri.

Ndoshta ky është edhe kuptimi më i bukur i një jete në shërbim: **uniforma mund të hiqet, por përkushtimi ndaj kujtesës nuk del kurrë në rezervë.**

NJË MIRËNJOHJE PËR TË GJITHA GRATË NË UNIFORMË

Gazeta “Ushtria” dëshiron të ndalet jo vetëm te historia e Vasilika Babos, por te historia e **të gjitha grave që kanë veshur dhe vazhdojnë të veshin uniformën e Forcave të Armatosura.**

Ato janë gra të brezave të ndryshëm, me histori dhe përvoja të ndryshme, por të bashkuara nga e njëjta zgjedhje: **t’i shërbejnë vendit me profesionalizëm, dinjitet dhe përkushtim.**

Disa prej tyre e kanë kaluar jetën mes kazermave, stërvitjeve dhe detyrave të vështira. Disa kanë shërbyer në poste drejtuese, në misione, në terren, në struktura mbështetëse apo në auditorët e institucioneve të edukimit ushtarak. Të tjera vazhdojnë sot të ndëtojnë karrierën e tyre, duke dëshmuar çdo ditë se uniforma nuk ka gjini, por **përgjegjësi, disiplinë dhe karakter.**

Ato kanë qenë dhe janë oficere, nënoficere, ushtarë, specialiste, pedagogë, mjeke, pilote, detare, inxhinierë, komunikuese dhe drejtuese. Në çdo detyrë kanë sjellë një dimension të veçantë të shërbimit: profesionalizmin, qëndrueshmërinë, përkushtimin dhe forcën për të përballuar sfidat.

Për shumë prej tyre, rruga e uniformës ka kërkuar edhe sakrifica personale. Ka nëna që kanë lënë fëmijët për të përmbushur një detyrë, bashkëshorte që kanë ndarë me familjet e tyre vështirësitë e jetës ushtarake, vajza që kanë zgjedhur një profesion kërkues dhe gra që kanë dëshmuar se karriera dhe familja mund të ecin së bashku, edhe kur rruga është e vështirë.

Vasilika Babo është një prej dëshmive të këtij rrugëtimi. Por ajo nuk është e vetme.

Pas saj qëndrojnë breza të tërë grash që kanë lënë gjurmë në historinë e Forcave të Armatosura dhe, përpara tyre, janë gratë e reja që sot vazhdojnë këtë rrugë.

Pikërisht për këtë, redaksia e gazetës **“Ushtria”** i konsideron historitë e grave në uniformë jo vetëm si histori personale, por si pjesë të **kujtesës dhe identitetit të Forcave të Armatosura.**

Mirënjohje për ato që shërbyen dje.

Respekt për ato që shërbejnë sot.

Dhe besim te ato që do të veshin uniformën nesër.

Sepse kontributi i grave në Forcat e Armatosura nuk është thjesht një kapitull i historisë së ushtrisë shqiptare.

Është një histori që vazhdon të shkruhet çdo ditë. Dhe për sa kohë që do të ketë gra që zgjedhin uniformën, qëndrojnë në rresht, përmbushin detyrën dhe mbajnë me dinjitet emrin e ushtarakut shqiptar, kjo histori do të vazhdojë të jetë një nga dëshmitë më të bukura të përkushtimit ndaj vendit.

Në emër të redaksisë së gazetës “Ushtria”, mirënjohje për të gjitha gratë në uniformë, për atë që kanë dhënë, për atë që japin dhe për atë që do të vazhdojnë të japin.

Respekt për shërbimin.

Nderim për sakrificën.

Mirënjohje për çdo grua që ka zgjedhur të shërbejë.





Përgatiti: **EDUARD DEMO**

17 GUSHT 1920 – VLORA NË PRAG TË ÇLIRIMIT

Tërheqja e trupave italiane, një hap vendimtar drejt rikthimit të administrimit shqiptar



17 gusht 1920 mbetet një nga datat domethënëse të Luftës Kombëtare të Vlorës. Pas muajsh përlëshjesh të ashpra dhe qëndrese të vendosur shqiptare, prania ushtarake italiane në Vlorë po hynte në fazën e fundit. Tërheqja e trupave italiane ishte bërë tashmë një realitet dhe fitorja e arritur në fushën e betejës po shndërrohej në një proces konkret politik, administrativ dhe territorial.

Lufta e Vlorës e vitit 1920 ishte një nga përballjet më të rëndësishme të Shqipërisë së viteve të para të shtetit shqiptar. Përballë një fuqie të madhe ushtarake, populli i Vlorës dhe forcat kombëtare shqiptare dëshmuar se mbrojtja e territorit dhe e sovranitetit nuk ishte vetëm një aspiratë politike, por një vullnet i gatshëm të mbrohej me sakrificë.

Nga fusha e betejës në tryezën diplomatike

Pas luftimeve të ashpra, çështja e Vlorës hyri në një fazë të re. Më 2 gusht 1920, në Tiranë, u nënshkrua Protokollit italo-shqiptar, nga kryeministri Sulejman Delvina dhe përfaqësuesi italian Gaetano Manzoni.

Marrëveshja parashikonte tërheqjen e trupave italiane nga Vlorë dhe pjesët e tjera të Shqipërisë, me përjashtim të ishullit të Sazanit.

Por Protokollit i Tiranës kishte një rëndësi që shkonte përtej largimit fizik të trupave. Ai shënonte një ndryshim të rëndësishëm politik: Italia pronte sovranitetin shqiptar mbi Vlorën dhe tërësinë territoriale të Shqipërisë.

Në zbatim të marrëveshjes, procesi i evakuimit kishte nisur më 3 gusht 1920. Tërheqja ishte planifikuar të zhvillohej në mënyrë të organizuar, duke shmangur kaosin dhe duke mundësuar kalimin gradual të administrimit të autoritetet shqiptare.

Dhe më 17 gusht, ky proces hyri në një prej fazave të tij më të rëndësishme.

17 gusht – lirohen patriotët shqiptarë

Një nga momentet më domethënëse të kësaj date ishte lirimi nga burgu i Sazanit i 24 të burgosurve shqiptarë, personalitete dhe patriotë të Vlorës.

Mes tyre ishin Jani Minga, Ali Asllani, Dom Mark Vasa dhe patriotë të tjerë.

Ata u dërguan drejt qytetit nën shoqërimin e xhandarmërisë shqiptare.

Lirimi i tyre kishte një peshë të veçantë simbolike. Pas muajsh përplasjeje, kur lufta po i afrohej fundit dhe pushteti italian mbi Vlorën po hynte në fazën e fundit, rikthimi i patriotëve shqiptarë ishte një tjetër shenjë se situata po ndryshonte.

Trupat italiane do të largoheshin fillimisht nga banesat e Vlorës dhe kodrat përreth, ndërsa më pas do të vijonte zbrazja e qytetit dhe kalimi gradual i administratës të autoritetet shqiptare.

Pra, fitorja nuk mjaftonte vetëm të shpallej.

Ajo duhej të merrej në dorë, të administrohej dhe të shndërrohej në rend e sovranitet shqiptar.

KOMITETI “MBROJTJA KOMBËTARE”

Në këtë proces, një rol të rëndësishëm politik e organizativ kishte Komiteti “Mbrojtja Kombëtare”, që kishte organizuar dhe drejtuar luftën në Vlorë.

Komiteti përbëhej nga dymbëdhjetë patriotë dhe kryesohej nga Osman Haxhiu. Krahës tij qëndronin figura të tjera të rëndësishme të lëvizjes kombëtare, ndërsa Qeveria e Tiranës kishte përfaqësuesin e saj pranë Komitetit, Spiro Jorgo Kolekën.

Fitorja e Luftës së Vlorës nuk mund të merrte kuptimin e saj të plotë pa kaluar nga fitorja ushtarake në kontrollin dhe administrimin e territorit.

Kjo ishte sfida e radhës.

Në këtë kuptim, tërheqja italiane ishte njëkohësisht proces ushtarak, administrativ dhe politik.

Pala shqiptare nuk ishte më thjesht ajo që kërkonte largimin e forcave italiane. Ajo po merrte përgjegjësinë për administrimin e territorit të çliruar dhe për garantimin e vazhdimësisë së jetës publike.

Nga lufta të administrimit

Dokumentet e kohës dëshmojnë se tërheqja ishte parashikuar të kryhej në mënyrë të organizuar.

Autoritetet shqiptare duhej të merrnin gradualisht në dorë funksionet administrative dhe të garantonin vazhdimësinë e shërbimeve dhe të veprimtarisë ekonomike.

Në këtë proces, rëndësi të veçantë kishte edhe

Xhandarmëria Shqiptare.

Nga pala shqiptare, mbikëqyrjen e zbatimit të marrëveshjes e kryenin, ndër të tjerë, kapiten Ferid Frashëri dhe toger Tosun Selenica, komandantët e dy Çetave të Korçës të Ushtrisë Kombëtare, të ngarkuar edhe nga Qeveria e Tiranës.

Kështu, ajo që ishte fituar me armë duhej të shndërrohej në rend, administrim dhe kontroll shqiptar mbi territorin.

NJË FITORE QË NUK PËRFUNDOI MË 17 GUSHT

17 gushti ishte një etapë vendimtare, por tërheqja italiane nuk përfundoi atë ditë.

Procesi i evakuimit vijoi deri në fillim të shtatorit. Dokumentet e kohës e lidhin përfundimin e tij me 2 shtatorin, ndërsa më **3 shtator 1920, forcat shqiptare hynë në Vlorë.**

Kështu u mbyll harku i një prej kapitujve më të lavdishëm të historisë së Shqipërisë së viteve të para të shtetit shqiptar.

Nga 5 qershori deri më 3 shtator 1920, Lufta Kombëtare e Vlorës u shndërrua në një dëshmi të fuqisë së bashkimit kombëtar.

17 gushti duhet kujtuar si dita kur fitorja ushtarake



shqiptare nisi të merrte formë konkrete në terren: pushtuesi po tërhiqej dhe administrimi i qytetit po kalonte drejt duarve shqiptare.

Fitorja e Luftës së Vlorës nuk ishte vetëm çlirimi i një qyteti.

Ajo forcoi shtetin shqiptar, mbrojti tërësinë territoriale të vendit dhe i dha një goditje të rëndë pretendimeve italiane mbi Vlorën dhe Shqipërinë.

Ishte një fitore që dëshmoi se një popull i bashkuar rreth një qëllimi kombëtar mund të përballet edhe me një ushtri të madhe dhe të organizuar.

KUJTESA QË NUK SHUHET

Pas çdo date historike qëndrojnë njerëzit. Pas çdo fitoreje qëndrojnë sakrificat. Dhe pas çdo flamuri që ngrihet mbi një qytet të çliruar janë ata që luftuan, vuajtën dhe qëndruan përballë rrezikut. Në Luftën e Vlorës ishin burra dhe gra të zakonshëm që bënë një zgjedhje të jashtëzakonshme: të vinin Shqipërinë mbi frikën dhe mbi interesin personal. **Ata luftuan. Sakrifikuan. Qëndruan. Dhe fituan.**

Sot, 106 vjet më pas, 17 gushti mbetet një datë që na kujton se sovraniteti nuk është një fjalë abstrakte. Ai është një përgjegjësi që kërkon sakrificë, unitet dhe vendosmëri.

Historia e Luftës së Vlorës është një kujtesë për çdo brez se liria dhe tërësia territoriale nuk janë dhurata.

Ato janë trashëgimi.

Dhe trashëgimia ruhet duke njohur historinë e atyre që e mbrojtën.

Nderim për dëshmorët!

Lavdi luftëtarëve të Luftës Kombëtare të Vlorës!

Lavdi të gjithë burrave dhe grave që dhanë gjithçka për Shqipërinë!

KUTIA KRONOLOGJIKE 1920

5 qershor 1920 – Nis faza e luftës së armatosur shqiptare në Vlorë;

2 gusht 1920 – Në Tiranë nënshkruhet Protokollit italo-shqiptar nga Sulejman Delvina dhe Gaetano Manzoni;

3 gusht 1920 – Nis procesi i evakuimit të trupave italiane;

17 gusht 1920 – Tërheqja italiane hyn në një fazë vendimtare; lirohen 24 patriotë shqiptarë nga burgu i Sazanit;

2 shtator 1920 – Dokumentet e kohës e lidhin me këtë datë përfundimin e procesit të evakuimit;

3 shtator 1920 – Forcat shqiptare hyjnë në Vlorë;

1920 – Lufta e Vlorës përfundon me një fitore me rëndësi të jashtëzakonshme për sovranitetin dhe tërësinë territoriale të Shqipërisë.



MUNDËSI STUDIMI NË AKADEMITË PRESTIGJIOZE USHTARAKE TË SHBA-së



3 KUOTA PËR TË RINJTË QË DUAN TË NDËRTOJNË TË ARDHMEN NË UNIFORMË

Qendra e Personel Rekrutimit hap mundësinë për kandidatët shqiptarë që dëshirojnë të ndjekin studimet në tri nga akademitë më të njohura ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

OFROHEN 3 (TRE) TË DREJTA STUDIMI:

Akademia Ushtarake “West Point”

1 kuotë studimi

Akademia Ushtarake Detare e SHBA-së

1 kuotë studimi

Akademia Ushtarake e Forcave Ajrore të SHBA-së

1 kuotë studimi

NJË HAP DREJT NJË KARRIERE NDËRKOMBËTARE

Studimi në akademitë ushtarake të Shteteve të Bashkuara ofron një mundësi të veçantë për formim akademik, ushtarak dhe profesional, duke i përgatitur të rinjtë për sfidat e sigurisë dhe mbrojtjes së të ardhmes.

AFATI I APLIKIMIT

Dokumentacioni duhet të dorëzohet pranë Qendrës së Personel Rekrutimit deri më 30 shtator 2026.

MOS E HUMB KËTË MUNDËSI!

Nëse ke ambicie, disiplinë dhe dëshirën për t'i shërbyer vendit, rruga jote drejt një formimi të nivelit të lartë mund të nisë sot.

APLIKO! PËRGATITU! SHËRBE! ARRI MAJAT!

Për informacion të mëtejshëm mbi kriteret dhe procedurat e aplikimit, kandidatët mund të drejtohen pranë Qendrës së Personel Rekrutimit dhe të konsultojnë faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes.

****FORCAT E ARMATOSURA TË SHQIPËRISË:
NJË KARRIERË. NJË MISION. NJË E ARDHME****